

4You magazine
www.magazineforyou.com
4You Magazine - Shqip
magazine4ushqip
radio K4
• 90.2 • 96.6 •
www.radiokfor.com
Revistë mujore e KFOR-it Nr. 202 - Dhjetor 2023
KFOR
КФОР
MUSICBOX
DAVID DRESHAJ
Falas

4You magazine

"4You Magazine" është publikim zyrtar i KFOR-it, prodhuar dhe financuar nga KFOR-i, i shtypur në Kosovë dhe shpërndahet pa pagesë. Përmbajtja nuk reflekton qëndrimin zyrtar të koalicionit apo të shteteve anëtare. KFOR-i pranon edhe i mirëpret opinionet tuaja dhe i publikon ato, por në formë të përmbledhur. Nëse kërkohet emri i autorit të mos tregohet, kjo mund të bëhet, por nuk do të publikohen letra anonime, shpifëse apo me qëllim të keq.

**Kryeredaktore:** Leonora Shabanaj Nikshiq
**Gazetarë:** Ali Rexha, Violeta Matovic, Jelena Simic Rasic
**Fotografitë:** Ekipi "4You"
**Design & Layout:** Bekim Shabani & Leopard Cana

Stafi editorial mund të kontaktohet në telefon:
**038/503-603-2139**
Letrat mund të dërgohen në adresën:
**HQ KFOR - Kosova Film;**
**"4You Magazine";**
**Strasbourg Building;**
**10000 Prishtinë**

E-mail:
**magazineforyou2003@gmail.com**
**www.magazineforyou.com**




*Kopertina: David DRESHAJ*

# Editorial

***Lexues të dashur,***
*Teksa e nisim muajin festiv të dhjetorit, zemrat tona mbushen me ngrohtësi, ngazëllim dhe me premtimin për fillime të reja. Kjo periudhë magjike nuk ka të bëjë vetëm me dritat vezulluese dhe dekorimet festive; është edhe kohë për reflektim, mirënjohje dhe përhapje gëzimi tek ata që na rrethojnë.*

*Urimet më të mira për festat e fundvitit për secilin prej jush! Dhjetori e sjell me vete një ndjenjë bashkimi, një rikujtim për të çmuar lidhjet që i kemi me familjen dhe miqtë. Kjo është një kohë për të shprehur dashurinë dhe mirënjohjen tonë, për të vlerësuar momentet që na kanë formësuar gjatë gjithë vitit. Teksa shkëmbejmë dhurata dhe të qeshura, të mos harrojmë se fryma e vërtetë e kësaj periudhe qëndron në lumturinë e dhënies dhe në ngrohtësinë e lidhjes njerëzore.*

*Në një botë që shpesh e përjetojmë me ritëm të shpejt dhe kaotik, muaji dhjetor na ofron një mundësi për t'u ndalur, për të marrë frymë thellë dhe për të reflektuar për vitin që e lamë pas. Le të festojmë arritjet tona, të mësojmë nga sfidat tona dhe të hyjmë në vitin e ri me shpresë dhe vendosmëri të përtërirë. Secili prej jush e ka fuqinë për të formësuar rrugëtimin tuaj dhe muaji dhjetor është koha e përsosur për të vendosur synime pozitive për të ardhmen.*

*Të jetosh në paqe dhe harmoni është një qëllim që rezonon me njerëzit e të gjitha moshave dhe si adoleshentë ju e luani një rol jetësor në formësimin e botës së të nesërmes. Le të jetë ky dhjetor një rikujtim se mirësia, mirëkuptimi dhe ndjeshmëria mund të krijojnë rryma të ndryshimit pozitiv. Shfrytëzoni një moment për të çmuar diversitetin që ndodhet rreth jush, përqafoni këndvështrime të ndryshme dhe synoni unitetin. Në frymën e këtyre festave, le të punojmë drejt ndërtimit të një bote ku të gjithë ndihen të vlerësuar dhe të përfshirë.*

*Jeta është një udhëtim i bukur dhe muaji dhjetor është koha e përkryer për të shijuar begatinë e tij. Mes tollovisë dhe ngutisë, ndajeni një moment për të vlerësuar gëzimet e vogla që ju rrethojnë – ngrohtësinë e një trikoje të rehatshme, shijen e kakaos së nxehtë e të qeshurat që jehojnë në ajër. Përqafoni thjeshtësinë e festave dhe gjeni gëzim në gjërat e vogla që e bëjnë jetën vërtet të veçantë.*

*Ndërsa i themi lamtumirë edhe një viti tjetër, le ta bartim frymën e dhjetorit me vete në të ardhmen. Qofshin muajt e ardhshëm të mbushur me zhvillim, qëndrueshmëri, dhe momente të lumturisë së pastër! Qoftë duke festuar me familjen, miqtë, qoftë duke eksploruar rrugën tuaj, mbani mend se ju e keni fuqinë për të krijuar një jetë që ju sjell përmbushje dhe lumturi.*

*Gëzuar të gjithëve Vitin e Ri plot me dashuri, të qeshura dhe magjinë e kësaj periudhe festive!*

***Gjithë të mirat!***

*Leonora*

# Indeksi




*2.* ***Editoriali, indeksi***
*4.* ***Shkolla e muajit:*** FUQIZIMI I ËNDRRAVE, FORMËSIMI I TË ARDHMES: NJË DEKADË MË PAS, SHKOLLA E LISMIRIT PO LULËZON
*6.* BREZAT E RINJ - E ARDHMJA E KOSOVËS
*8.* ***Music Box:*** DAVID DRESHAJ: DUA TË BËJ MUZIKË QË I BËNË BALLË KOHËS
*12.* ARTI SI URË
*14.* ***World around Us:*** TRADITAT E VITIT TË RI NËPËR BOTË
*16.* ***Do it Yourself:*** SI TË BËJMË NJË ZBUKURIM BREDHI NGA SHKOPINJTË E AKULLOREVE?
*18.* ***Moviemania:*** FILMAT E RI NË MUAJIN DHJETOR 2023
*20.* ***Health & Sports:*** JUDE BELLINGHAM ADOLESHENTI SENSACIONAL QË E PO E PUSHTON ME VRULL REAL MADRIDIN
*22.* ***Generation #:*** A ËSHTË "BEREAL" AI I VËRTETI? NJË VËSHTRIM NË BOTËN E AUTENTICITETIT
*24.* LUNDRIMI NË EPOKËN DIGJITALE: RËNDËSIA E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT
*26.* ***Your opinion about:*** MENDIMI JUAJ PËR FILMAT ME SUPER HERONJ?
*28.* ***Wellbeing & teens:*** VITI I RI, DIÇKA E RE NË TY? APO - T'VAZHDOJMË ME T'VJETRËN?
*30.* TË MËSOJMË SË BASHKU!
*32.* ***Did you know?*** DIMRI

# Editorial

***Dear readers,***
*As we usher in the festive month of December, our hearts are filled with warmth, excitement, and the promise of new beginnings. This magical season is not just about twinkling lights and festive decorations; it's a time for reflection, gratitude, and spreading joy to those around us.*

*Season's greetings to each and every one of you! December brings with it a sense of togetherness, a reminder to cherish the bonds we share with family and friends. It's a time to express our love and gratitude, to appreciate the moments that have shaped us throughout the year. As we exchange gifts and laughter, let's not forget the true spirit of the season lies in the joy of giving and the warmth of human connection.*

*In a world that often feels fast-paced and chaotic, December offers us an opportunity to pause, take a deep breath, and reflect on the year that has passed. Let's celebrate our accomplishments, learn from our challenges, and enter the new year with renewed hope and determination. Each of you has the power to shape your own journey, and December serves as the perfect time to set positive intentions for the future.*

*Living in peace and harmony is a goal that resonates with people of all ages, and as teenagers, you play a vital role in shaping the world of tomorrow. Let this December be a reminder that kindness, understanding, and empathy can create ripples of positive change. Take a moment to appreciate the diversity around you, embrace different perspectives, and strive for unity. In the spirit of the season, let's work towards building a world where everyone feels valued and included.*

*Life is a beautiful journey, and December is the perfect time to savour its richness. Amidst the hustle and bustle, take a moment to appreciate the small joys that surround you – the warmth of a cozy sweater, the taste of hot cocoa, the sound of laughter echoing through the air. Embrace the simplicity of the season and find joy in the little things that make life truly special.*

*As we bid farewell to another year, let's carry the spirit of December with us into the future. May the coming months be filled with growth, resilience, and moments of pure joy. Whether you're celebrating with family, friends, or exploring your own path, remember that you have the power to create a life that brings you fulfilment and happiness.*

*Wishing you all a Happy New Year filled with love, laughter, and the magic of the season.*

***With warm regards,***

*Leonora*

# Index





*3.* ***Editorial, index***

*5.* ***School of the month:*** EMPOWERING DREAMS, SHAPING FUTURES: A DECADE ON, LISMIR SCHOOL FLOURISHES

*7.* YOUNG GENERATIONS: FUTURE OF KOSOVO

*9.* ***Music Box:*** DAVID DRESHAJ: I WANT TO MAKE MUSIC FOR AGES

*13.* ART AS A BRIDGE

*15.* ***World around Us:*** NEW YEAR'S EVE TRADITIONS AROUND THE WORLD

*17.* ***Do it Yourself:*** HOW TO MAKE A CHRISTMAS TREE DECORATION FROM FROM POPSICLES?

*19.* ***Moviemania:*** DECEMBER 2023 MOVIE RELEASES

*21.* ***Health & Sports:*** JUDE BELLINGHAM: THE TEEN SENSATION TAKING REAL MADRID BY STORM

*23.* ***Generation #:*** IS 'BEREAL' THE REAL DEAL? A PEEK INTO THE WORLD OF AUTHENTICITY

*25.* NAVIGATING THE DIGITAL AGE: THE IMPORTANCE OF INFORMATION VERIFICATION

*27.* ***Your opinion about:*** YOUR OPINION ABOUT WEEKEND PASTIME?

*29.* ***Wellbeing & teens:*** NEW YEAR, NEW YOU? OR WILL IT BE - THE SAME OLD AGAIN?

*31.* LET'S LEARN TOGETHER!

*32.* ***Did you know?*** WINTER



**4You magazine**

"4You Magazine" is an official publication of KFOR, produced and financed by KFOR, printed in Kosovo and distributed freely. The contents do not necessarily reflect the official point of view of the coalition or that of any of its member states. KFOR accepts and welcomes your opinions, it will publish some of these, eventually in a condensed form. If requested the name of the writer will be withheld but no anonymous, defamatory or malicious letters will be printed.

**Chief Editor:**
Leonora Shabanaj Nikshiq
**Journalists:** Ali Rexha, Violeta Matovic, Jelena Simic Rasic
**Photos by:** "4You" Team
**Design & Layout:**
Bekim Shabani & Leopard Cana

The editorial staff can be contacted on:
**038/503-603-2139**
Any letters can be sent at:
**HQ KFOR - Film City;**
**"4You Magazine";**
**Strasbourg Building;**
**10000 Pristina**

E-mail:
**magazineforyou2003@gmail.com**
**www.magazineforyou.com**





*Cover:*
*David DRESHAJ*

# *FUQIZIMI I ËNDRRAVE, FORMËSIMI I TË ARDHMES: NJË DEKADË MË PAS,* **SHKOLLA E LISMIRIT** *PO LULËZON*




*Në fshatin e qetë të Lismirit, që gjendet pranë lumit Sitnicia, ndodhet "Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët Lismiri". Themeluar në vitin 1946, ky institucion arsimor ka kaluar dekada të ndryshimeve, duke e përshtatur strukturën dhe fokusin për t'i përmbushur nevojat e ndryshueshme të komunitetit. Rishtas, e kishim privilegjin që ta vizitojmë sërish këtë shkollë, me ftesë nga drejtoresha e shkollës, znj. Shemsie Fetahu, duke shënuar pothuajse një dekadë që nga takimi im i parë me korridorët e saj.*



**znj. Shemsie Fetahu - drejtoreshë**

### Një trashëgimi e pasur

Shkolla e Lismirit i ka rrënjët në vitin 1946, kur u themelua. Gjatë viteve, ajo pësoi shumë transformime, duke u bërë nga një shkollë katër-vjeçare në një institucion të plotë tetë-vjeçar. Shkolla e fitoi pavarësinë në vitin 1992, kur e mori emrin SHFMU "Lismiri" sipas vetë fshatit. Ndërtesa e tanishme e shkollës, e ndërtuar në vitin 1988, qëndron me krenari në hyrje të fshatit, duke e ofruar një mjedis të bollshëm dhe të përshtatshëm për mësim.

### Një pishtar i arsimit

Në vitin akademik 2023/24, shkolla e Lismirit i ka mirëpritur 154 nxënës nga niveli parashkollor deri në klasën e nëntë. Zotimi për arsim cilësor është i dukshëm te 21 mësimdhënësit e përkushtuar dhe dy punonjësit teknik që punojnë bashkë për ta kultivuar një përvojë akademike të pasur.

### Investimi në cilësi

Shkolla krenohet me hapësirën dhe objektet e saj, duke e bërë të mundur mësimin në vetëm një orar mësimor, gjë që mundëson mësimdhënie efektive. Përkushtimi për arsim cilësor thellohet edhe më tej me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit mësimdhënës, duke u siguruar që ata të jenë të kualifikuar për ta realizuar kurrikulën e re në mënyrë efektive.

### Bashkëpunimi me komunitetin

Shkolla e Lismirit dallohet për bashkëpunimin e fortë me prindërit, duke e krijuar një trekëndësh pedagogjik të fortë Nxënës-Shkollë-Prindër. Tradita e shkollës për angazhimin në komunitet ka çuar në iniciativa të suksesshme, duke përfshirë veprimtari vullnetare, programe festive, ekskursione, gara sportive dhe veprimtari shkencore.

### Kremtimi i arritjeve

Krenaria e shkollës së Lismirit qëndron në arritjet e shkëlqyera të nxënësve të saj. Pavarësisht se është një institucion më i vogël, kjo shkollë është shquar në fusha të ndryshme, duke filluar nga disiplina në punë dhe realizimi i metodologjive pedagogjike e deri te pjesëmarrja aktive në projekte kombëtare dhe promovimi i trashëgimisë kulturore.

Në mes të shumë arritjeve, drejtoresha Fetahu e veçoi projektin "Të Drejtat Tona". Kjo nismë, e mbështetur zemërgjerësisht nga Ambasada e Sllovenisë, synonte monitorimin e aktiviteteve klasore nga ekspertët e Ministrisë së Arsimit. Në përfundim, shkolla e Lismirit, në veçanti klasa e znj. Ganimete Musa, u vlerësua si "Klasa më e mirë-menaxhuar" në Komunën e Fushë Kosovës. Madje, nxënësit u ftuan të shfaqnin arritjet e





# EMPOWERING DREAMS, SHAPING FUTURES: A DECADE ON, LISMIR SCHOOL FLOURISHES

*In the quiet village of Lismir, nestled by the Sitnicia River, stands Lismir Elementary and Junior High School (EJHS). Established in 1946, this educational institution has weathered decades of change, while adapting its structure and focus to meet the evolving needs of the community. Recently, we had the privilege of revisiting this school, an invitation extended by the school's principal Mrs. Shemsie Fetahu, marking almost a decade since my first encounter with its halls.*

tyre në një konferencë në Deçan, ku e lanë një përshtypje të fortë. Ndër sukseset e tjera të arritura nga nxënësit përfshihet vendi i dytë në garën komunale të matematikës dhe vendin i tretë në shah, klube aktive shkollore të gjuhës, matematikës, ekologjisë, kërcimit dhe komedisë, e kështu me radhë.

### Rruga përpara

Shkolla e Lismirit ka plane ambicioze për të ardhmen. Kalimi në mësim tërëditor dhe përmirësimi i hapësirave praktike mësimore janë prioritetet kryesore. Shkolla parashikon që këto ndryshime jo vetëm që do ta përmirësojnë suksesin individual dhe klasor, por gjithashtu do të kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm të personaliteteve të nxënësve.

### Sfidat dhe aspiratat

Teksa i kremtojnë sukseset, në këtë shkollë e pranojnë se ka sfida, si mungesa e laboratorëve për punë praktike dhe objekteve sportive. Numri i vogël i mësimdhënësve dhe emigrimi i banorëve nga viset rurale në ato urbane dhe jashtë vendit gjithashtu paraqesin shqetësime të vazhdueshme.

### Mesazhi përfundimtar

Në një mesazh të sinqertë për rininë e Kosovës, drejtoresha Fetahu i inkurajoi ata që ta pasurojnë dijen përmes leximit, t'i kthejnë ëndrrat në realitet me punë sistematike dhe të planifikuar, dhe t'i shfrytëzojnë mjetet e komunikimit për zgjerimin e dijes, më shumë se sa vetëm për argëtim. Ajo, gjithashtu ua përkujtoi mësimdhënësve dhe prindërve rolin e tyre të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për nxënësit.

***Gjatë vizitës së dytë në këtë shkollë, ishte kënaqësi e veçantë për ekipin tonë që të dëgjojë dhe të shohë rritjen dhe arritjet e shkollës së Lismirit. Nga ajo që pamë, mund të përfundojmë me siguri se kjo shkollë nuk është thjesht një qendër arsimore, por është një vend që i ushqen ëndrrat dhe aspiratat, ku puna bashkëpunuese e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve e thurin një tapiseri suksesi që rezonon larg kufijve të Lismirit.***

### A storied legacy

Lismir School traces its roots back to 1946 when it was founded. Over the years, it underwent various transformations, from a four-year school to a comprehensive eight-year institution. The school achieved independence in 1992, earning the name EJHS "Lismiri" after the village itself. The current school building, constructed in 1988, proudly sits at the entrance of the village, providing an ample and conducive environment for learning.

### A beacon of education

In the 2023/24 academic year, Lismir School welcomed 154 students from preschool to the ninth grade. The commitment to quality education is evident among the 21 dedicated educators and two technical staff who diligently work together to foster an enriching academic experience.

### Investing in quality

The school boasts sufficient space and facilities, allowing for a single-shift schedule that accommodates effective teaching. The commitment to quality education is further underscored by the continuous professional development of the teaching staff, ensuring they are well-equipped to implement the new curriculum effectively.

### Community collaboration

Lismir School stands out for its strong collaboration with parents, forming a robust pedagogical triangle of Students-School-Parents. The school's tradition of community engagement has led to successful initiatives, including voluntary actions, festive programs, excursions, sports competitions, and knowledge-sharing activities.

### Celebrating achievements

The pride of Lismir School lies in the remarkable achievements of its students. Despite being a smaller institution, this school has excelled in various areas, from discipline in work and the implementation of pedagogical methodologies to active participation in national projects and the promotion of cultural heritage.

Among the many achievements, principal Fetahu, singled out “Our Rights” project. This initiative, generously supported by the Slovenian Embassy, aimed at monitoring classroom activities by Ministry of Education experts. In conclusion the Lismir School, namely the class of Mrs. Ganimete Musa was acclaimed as the "Best-Managed Classroom" in Fushe Kosove Municipality. The students were even invited to showcase their achievements at a conference in Deçan, leaving a lasting impression. Other notable successes achieved by the students are second place in municipal math competition and third place in chess, active linguistic, math, ecology, dance, and comedy school clubs, and the list goes on.

### Looking forward

Lismir School has ambitious plans for the future. The transition to full-day classes and the enhancement of practical teaching spaces are top priorities. The school envisions these changes will not only improve individual and class success but also contribute to the overall development of students' personalities.

### Challenges and aspirations

While celebrating successes, the school acknowledges challenges, including the lack of laboratories for practical work and sports facilities. The small number of teaching staff and the migration of residents from rural to urban areas and abroad also pose ongoing concerns.

### Final message

In a heartfelt message to the youth of Kosovo, principal Fetahu encouraged them to enrich their knowledge through reading, turn dreams into reality with systematic and planned efforts, and use communication tools for knowledge expansion rather than mere entertainment. She also reminded the educators and parents of their crucial role in providing continuous support to the students.

***As this was a return visit to this school, it was a particular pleasure for our team to witness the growth and achievements of Lismir School. From what we saw, we can confidently conclude that this school is not just a center for education; it's a nurturing ground for dreams and aspirations, where the collaborative efforts of students, educators, and parents create a tapestry of success that resonates far beyond the borders of Lismir.***

# BREZAT E RINJ: *E ARDHMJA E KOSOVËS*




***Në mesin e muajit nëntor, në kampin "Villaggio Italia" në Bello Polje afër Pejës, u mbajt tryeza e rrumbullakët me titull "Gjeneratat e të rinjve: Ardhmëria e Kosovës". Të ftuar nga Komandanti i Komandës Rajonale-Perëndim të KFOR-it, kolonel Gabriele Vacca, kryetarë komunash, anëtarë të organizatave të shoqërisë civile, këshilltarë dhe përfaqësues të komuniteteve pakicë nga 15 komuna në perëndim të Kosovës u mblodhën për të diskutuar për rininë si një burim thelbësor për të ardhmen e Kosovës. Tema qendrore e tryezës ishte emigracioni, një realitet i përhapur në Kosovë, që prek kryesisht gjeneratat e reja që nuk shohin një të ardhme të ndritur në Kosovë.***

### *Koloneli Vacca: "Rinia, themeli i së ardhmes"*

Pasi u uroi mirëseardhje të gjithë të ftuarve, kolonel Gabriele Vacca, Komandant i Komandës Rajonale-Perëndim, shpjegoi se qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi i arsyeve pse gjithnjë e më shumë të rinj po shprehin dëshirën e tyre për të emigruar në vende të tjera. "Disa prej jush kanë vlerësuar se kushtet më të mira të jetesës dhe punës, pagat më të larta, shpeshherë të ndikuar nga 'mitet e rreme' të përforcuara nga mediat sociale dhe nga diaspora, janë disa nga arsyet pse të rinjtë duan të emigrojnë", tha Komandant Vacca. Ai vazhdoi duke theksuar se edhe pse qëllimi kryesor i KFOR-it në Kosovë është ruajtja e një mjedisi të qetë dhe të sigurt, ai (KFOR-i) gjithashtu inkurajon zhvillimin e një Kosove të qëndrueshme, demokratike, multietnike dhe paqësore. "Kjo është arsyeja pse sot jemi mbledhur këtu për të identifikuar problemet tona të përbashkëta, për të gjetur zgjidhje të suksesshme dhe strategji të ndryshme. Pasi ky është hapi i parë drejt adresimit të kësaj çështjeje sepse të rinjtë janë e ardhmja e Kosovës".



### *Investimi në arsim sjell përfitime afatgjata*

Ambasadori italian në Prishtinë, Dr. Antonello De Riu, e filloi prezantimin e tij duke theksuar se në një shoqëri si Kosova, që ka një nga popullatat më të reja në Evropë, çdo strategji që synon të promovojë dhe diversifikojë zhvillimin e saj ekonomik duhet të fokusohet në ndërtimin e kapitalit njeri dhe fuqizimin e brezave të ardhshëm, sepse të rinjtë janë e ardhmja e çdo shoqërie. Kjo është arsyeja pse Italia ka përqendruar shumicën e përpjekjeve dhe projekteve të saj ndihmëse në Kosovë drejt arsimit dhe rinisë. Ndër projektet e theksuara ishin: 'Pedakos' - për arsim parashkollor, 'HoReCa' - trajnim për gastronomi dhe mikpritje për shkollat e mesme, dhe 'Shkathtësitë dixhitale për të gjithë', duke ofruar trajnime për aftësi digjitale për 200 të rinj nga Kosova me prejardhje të ndryshme etnike. Sipas ambasadorit De Riu, të rinjtë e arsimuar dhe të aftë mund të nxisin sipërmarrjen dhe inovacionin, duke çuar përfundimisht në rritje ekonomike dhe prosperitet.



### *Planifikimi më i mirë për nevojat e tregut të punës*

Dr. Alma Shehu Lokaj, prorektore për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, theksoi rëndësinë e planifikimit për të përmbushur nevojat e tregut të punës në Kosovë me profesionistë të rinj të kualifikuar. Për këtë qëllim ajo avokoi për bashkëpunim ndërmjet institucioneve qeveritare, akademisë dhe industrisë. Kryetari i Komunës së Suharekës, z. Bali Muharremaj, u pajtua me vlerësimin e Shehu-Lokajt dhe shtoi se ka pasur vonesa në planifikim për kërkesat e Kosovës. Prandaj, ai bëri thirrje për një ndryshim të fokusit drejt fushave thelbësore për tregun e punës në Kosovë. Sipas tij, këto vonesa janë arsyeja pse aktualisht jemi duke u përballur me një situatë ku shumë të rinj studiojnë për drejtësi apo ekonomi, por na mungojnë njerëz në fusha të tjera jetike sidomos në sektorin privat. Në lidhje me këtë, shumica e përfaqësuesve të komunave ranë dakord që atraktiviteti i sektorit privat mund të rritet tek të rinjtë duke mbështetur zhvillimin e shkollave të programeve profesionale dhe duke ndihmuar sipërmarrësit që të zhvillojnë

ndërmarrje të vogla dhe të mesme në gjendje të ofrojnë kushte më të mira pune, paga apo sigurime adekuate shëndetësore.

**Drejtimi i vëmendjes së fëmijëve në kulturë dhe edukim**
Millan Angjelkoviq, drejtor i shkollës fillore në Gorazhdevc, theksoi rëndësinë që komunitetet t'i përkushtohen edukimit të shëndetshëm të fëmijëve. Ai theksoi nevojën për dialog konstruktiv ndërmjet institucioneve, universiteteve, shkollave, bizneseve vendore dhe organizatave ndërkombëtare për të adresuar nevojat dhe pritshmëritë e të rinjve, duke i ndihmuar ata të vendosin të qëndrojnë në Kosovë duke i inkurajuar ata që të bëhen aktorë aktivë brenda shoqërisë.

**Roli parësor i arsimit**
Në fund, pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët, në mes të vështrimeve të tjera kyçe, në mënyrë kolektive pohuan se arsimi shquhet si investimi më vital për prosperitetin dhe zhvillimin e ardhshëm të Kosovës. Megjithatë, investimi në arsim duhet të shoqërohet me planifikim të duhur, në mënyrë që nevojat e tregut të punës të jenë në përputhje me profilet e studimit dhe kurset e formimit profesional që u ofrohen të rinjve.



*Rëndësia e edukimit*
*"Njerëzit e arsimuar janë të pajisur më mirë për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote në jetën qytetare. Arsimi pro movon barazinë shoqërore dhe lëvizshmërinë, duke u mundësu ar individëve të të gjitha prejar dhjeve të realizojnë potencialin e tyre të plotë, pavarësisht nga origjina ose rrethanat e tyre, duke çuar në një shoqëri më të drejtë." – Antonello De Riu, am basador i Italisë në Kosovë.*

Na vizitoni në:
Visit us at:

# YOUNG GENERATIONS: FUTURE OF KOSOVO

**In mid-November, at the "Villaggio Italia" camp in Belo Polje near Pec, a round table titled "Youth Generations: The Future of Kosovo" was held. Invited by the commander of KFOR's regional command west, Colonel Gabriele Vacca, mayors, members of civil society organizations, advisors, and representatives of minority communities from 15 municipalities in western Kosovo gathered to discuss youth as an essential resource for Kosovo's future. The central theme of the round table was emigration, a widespread reality in Kosovo, primarily affecting young generations who do not see a bright future in Kosovo.**

**Colonel Vacca: 'Youth, the foundation for the future'**
After welcoming all the guests, Colonel Gabriele Vacca, commander of the Regional Command West, explained that the purpose of this round table was to discuss the reasons why more and more young people are expressing their desire to emigrate to other countries. "Some of you have assessed that better living and working conditions, higher salaries, often influenced by 'false myths' amplified by social media and the diaspora, are some of the reasons why the young want to emigrate," Commander Vacca stated. He went on stressing that although KFOR's main goal in Kosovo is to maintain a safe and secure environment, it also encourages the development of a sustainable, democratic, multiethnic, and peaceful Kosovo. "This is why we have gathered here today to identify our joint problems, to find successful solutions and various strategies. As this is the first step towards addressing this issue because the youth are the future of Kosovo."

**Investing in education yields long-term gains**
Italian Ambassador in Pristina, Dr. Antonello De Riu, started his presentation by remarking that in a society like Kosovo, that has one of the youngest populations in Europe, any strategy that aims to promote and diversify its economic development must focus on building the human capital and empowering future generations, because the youth are the future of any society. Which is why Italy has focused the majority of its assistance efforts and projects in Kosovo towards education and youth. Among the highlighted projects were: 'Pedakos' - for preschool education, 'HoReCa' - gastronomy and hospitality training for high schools, and 'Digital Skills for All', providing digital skills training to 200 Kosovo youngsters from diverse ethnic backgrounds. According to Ambassador De Riu, educated and skilled youth can drive entrepreneurship and innovation, ultimately leading to economic growth and prosperity.

**Better planning for labor market needs**
Dr. Alma Shehu Lokaj, vice-rector for teaching, student affairs and scientific research at Haxhi Zeka University in Peja/Pec, emphasized the importance of planning to meet the labor market's needs in Kosovo with qualified young professionals. To this purpose she advocated for collaboration among governmental institutions, academia, and industry. The Mayor of Suhareka/Suva Reka, Mr. Bali Muharremaj, concurred with Shehu Lokaj's assessment and added that there have been delays in planning for Kosovo's requirements. Therefore, he called for a shift in focus towards the essential fields for Kosovo's job market. According to him these delays are the reason why we are currently facing a situation when too many young people study law or economy, but we lack people in other vital fields, especially in the private sector. In respect of that, most of the municipality representatives agreed that the attractivity of private sector cam be enhanced among youngsters by supporting the development of vocational programs schools and help the entrepreneurs to develop small and medium enterprises able to provide better working conditions, salaries or adequate heath insurances.

**Directing children's attention to culture and upbringing**
Milan Anđelković, director of the Elementary School in Gorazhdevc/Gorazdevac, emphasized the importance of communities dedicating themselves to the healthy upbringing of children. He highlighted the need for constructive dialogue between institutions, universities, schools, local businesses, and international organizations to address the needs and expectations of young people, helping them decide to stay in Kosovo by encouraging them to become active actors within the society.

**The paramount role of education**
In the end, the participants of the round table, among other key insights, collectively affirmed that education stands out as the most vital investment for Kosovo's future prosperity and development. However, investment in education must be accompanied with appropriate planning so that the needs of the labor market are compatible with the studying profiles and vocational training courses that are offered to young people.

*Importance of education*
*"Educated people are better equipped to participate meaningfully in civic life. Edu cation promotes social equality and mobility, enabling individuals from all backgrounds to realize their full potential regardless of their origin or circumstances, leading to a fairer society." – Antonello De Riu, Italian Ambassador in Kosovo.*



# DAVID DRESHAJ

## *"DUA TË BËJ MUZIKË QË I BËN BALLË KOHËS"*

**Çfarë ju tërhoqi fillimisht në botën e muzikës?**
Nuk e di. Mendoj që artist lind, muzika është pasion, kurse këngëtar zgjedh që të bëhesh, por gjithçka që ka të bëj me muzikën, notat muzikore, tiparet, karakteristikat dhe sjelljet e një artisti që në fëmijëri i kam pasur edhe në të folur.

**A mund të na tregoni për ndikimet tuaja muzikore dhe se si ato e kanë formësuar stilin tuaj?**
Jam rritur me ndikim nga zhanre, stile dhe rryma të ndryshme muzikore, të cilat kanë ndikuar edhe në mënyrën time të të kënduarit, interpretimit dhe performimit si artist. Ndër artistët që kanë ndikuar më shumë te unë do të veçoja Michael Jackson, Justin Timberlake, Whitney Houston, etj.

**A mund të tregoni ndonjë anekdotë apo histori personale për këngët tuaja?**
Po e kam një këngë pas së cilës qëndron një histori personale. Bëhet fjalë për këngën "Asaj." Këtë këngë e kam punuar nga shpirti dhe zemra dhe ia kam dedikuar motrës sime dhe e kam kënduar për herë të parë në ditën e dasmës së saj. Më pas, kjo befasi u kthye në një këngë hit në Shqipëri, Kosovë dhe më gjerë dhe ky është momenti më krenar në karrierën time deri tani.

**A mund ta përshkruani përvojën tuaj duke performuar live për një**

**Mirë se vini në botën magjepsëse të muzikës përmes kësaj interviste ekskluzive me këngëtarin dhe artistin e njohur David Dreshaj. Në këtë bisedë të sinqertë, ne do të flasim për hapat e parë të rrugëtimit muzikor të Davidit, ndikimet e tij, dhe historitë që i kanë formësuar melodinë e tij. Për redaksinë tonë është një privilegj që të shpalosim shkrirjen unike të artit dhe muzikës që e përkufizojnë këtë muzikant të talentuar. Bashkohuni me ne në prapaskenë, përmes këtij portreti intim të David Dreshaj, dhe zbulojeni botën e tij të jashtëzakonshme muzikore dhe artistike.**

**audiencë?**
Asnjëherë nuk është njëlloj. Asnjëherë emocionet dhe adrenalina nuk janë të njëjta.

**Si qëndroni të motivuar dhe frymëzuar për të krijuar muzikë të re?**
Muzikën e dua shumë dhe e bëj me shumë dëshirë dhe pasion.

**A ka ndonjë projekt apo bashkëpunim të ardhshëm për të cilin jeni të emocionuar?**
Po, planifikoj t'i realizojë disa projekte solo dhe bashkëpunime me muzikantë nga trojet shqiptare dhe më gjerë. Një nga këto projekte, e që po e zbuloj për herë të parë ekskluzivisht për 4You Magazine, është kënga që e kam përgatitur në bashkëpunim me Young Zerka.



**Çfarë e shihni si të ardhmen e muzikës dhe karrierës suaj?**
Të ardhmen e muzikës dhe karrierës sime e shoh në realizmin e shumë albumeve, këngëve, dhe baladave të

# DAVID DRESHAJ

## "I WANT TO MAKE MUSIC FOR AGES"

**Welcome to the fascinating world of music through this exclusive interview with renowned singer and artist David Dreshaj. In this candid conversation, we'll talk about the early steps of David's journey, his influences, and the stories that have shaped his tunes. It is our editorial privilege to unfold the unique fusion of art and music that defines this talented musician. Join us behind the scenes, through this intimate portrait of David Dreshaj, and discover his extraordinary musical and artistic world.**

**What did you like first about the world of music?**
I don't know. I think you are born an artist, music is a passion, and you choose to become a singer, but everything that has to do with music - musical notes, features, characteristics and behaviours of an artist - I had them even in my speech from early childhood.

**Can you tell us about your musical influences and how they have shaped your style?**
I grew up influenced by different music genres, styles and melodies, which have also influenced my way of singing, interpreting and performing as an artist. Among the artists who have influenced me the most, I would single out Michael Jackson, Justin Timberlake, Whitney Houston, etc.

**Can you share any personal anecdotes or stories about your songs?**
Yes, I have a song behind which there is a personal story. It is about the song "Asaj." I wrote this song from the bottom of my heart and dedicated it to my sister and sang it for the first time on her wedding day. Then surprisingly, this turned into a hit song in Albania, Kosovo and beyond and it is the proudest moment of my career so far.

**Can you describe your experience performing live in front of an audience?**
It is never the same. Emotions and adrenaline are never the same.

**How do you stay motivated and inspired to create new music?**
I love music very much and I do it with great desire and passion.

**Are there any upcoming projects or collaborations you're excited about?**
Yes, I plan to have some solo projects and collaborations with Albanian musicians and beyond. One of these projects, which I am revealing for the first time exclusively for 4You Magazine, is the song I have prepared in collaboration with Young Zerka.

**What do you see as the future of your music and career?**
I see the future of my music and career having many albums, songs, and great ballads, which will continue to be heard for decades.

**What advice would you give to aspiring musicians trying to break into the industry?**
To believe in themselves and work hard, but also to not take to their heart every obstacle that comes in their and never stop moving forward.

**How do you handle criticism and feedback from your fans and critics?**

mëdha, të cilat do të vazhdojnë të dëgjohen për dekada të tëra.

**Çfarë këshille do t'u jepnit muzikantëve aspirantë që përpiqen të futen në industri?**
Të besojnë te vetja dhe të punojnë shumë, por edhe ta marrin çdo pengesë që u del përpara me sportivitet, dhe të mos ndalen së ecuri para.

**Si i trajtoni kritikat dhe reagimet nga fansat dhe kritikët tuaj?**
Kritikat dhe reagimet nga fansat, të cilët i vlerësoj si kritikët kryesor, i marr me shumë seriozitet dhe gjithmonë mundohem të përmirësohem, kur këto kritika janë me vend. Qoftë për t'u përmirësuar si artist apo edhe si person.



**A keni një vend apo festival të ëndrrave ku do të dëshironit që të performoni?**
Po ka shumë vende, festivale, koncerte, manifestime dhe gara botërore të ëndrrave. Një prej këtyre garave që do ta veçoja tani është që të marrë pjesë në Evrovizion.

**Cili është vendi më i pazakontë apo i papritur ku keni gjetur frymëzim për një këngë?**
Vendi më i pazakontë dhe i papritur ku unë kam gjetur frymëzim për një këngë, tekst, vijë melodike, fjali, varg, apo titull tematik ka qenë në gjumë. Kur jam zgjuar e kam shkruar ose incizuar veten diku menjëherë, sepse e kam ditur që nëse nuk e bëjë këtë do të më humb si ide apo frymëzim.

**Nëse do të mund të bashkëpunonit me ndonjë muzikant, të vdekur apo të gjallë, kush do të ishte?**
Do të dëshiroja shumë të realizojë një bashkëpunim me Michael Jackson. Po ashtu, një bashkëpunim tjetër i ëndrrave është me Dua Lipën, e cila është krenaria e të gjithë shqiptarëve.




**Cila është kënga juaj e preferuar për karaoke kur nuk jeni duke e performuar muzikën tuaj?**
Kënga që unë preferoj ta këndoj në karaoke dhe interpretim live, jashtë repertorit tim, është kënga 'Bless The Broken Road' nga Rascal Flatts.

**A keni ndonjë ritual apo zakon që e zbatoni para shfaqjeve?**
Unë jam katolik malësor, kështu që rituali i vetëm që e zbatoj para shfaqjeve është kryqi para daljes në skenë.

**Nëse nuk do të ishit muzikant, çfarë karriere tjetër mendoni se do të kishit ndjekur?**
Nëse nuk do të isha këngëtar dhe nuk do të luaja piano dhe kitarë, do të kisha ndjekur një karrierë në vizatim ose dizajn. Sepse gjithmonë e gjej veten në art dhe arti nuk më lodh dhe as nuk më shteron kurrë.

**Nëse do të mund të udhëtonit në kohë në ndonjë epokë muzikore, cila do të ishte ajo?**
Nëse do të mund të udhëtoja pas në kohë, kjo do të ishte padyshim në vitet e '80-ta. Gjithçka nga kjo periudhë muzikore më mahnit.

**Cili është ushqimi juaj ngushëllues kur jeni në turne apo në studio?**
Kur jam në turne apo në studio duke regjistruar muzikë, ushqimi im i preferuar është diçka e thjeshtë, ndonjë ujë i gazuar, kafe apo çaj, dhe ndoshta fara luledielli sa për t'u dukur "i çikë më cool" dhe si "studio guy" - 😀😀😀.

**Nëse jeta juaj do të ishte një film, çfarë zhanri do të ishte dhe kush do të të luante ty?**



Nëse jeta ime do të ishte një film do të ishte zhanër dramë - 😀😀😀 pak shaka. Kurse, për të më luajtur mua, më së miri do të ishte ndonjë aktor që di edhe të këndojë.

**Cili është destinacioni juaj i ëndrrave për pushime për t'u çlodhur pas një turneu?**
Destinacioni im i ëndrrave për pushime, për t'u çlodhë pas një turneu është Miami, Florida.

**Cili është instrumenti muzikor më i çuditshëm apo unik që i keni rënë ndonjëherë?**
Lahuta.

**Cili është artikulli më ekstravagant i gardërobës suaj në turne?**
Artikulli më ekstravagant i gardërobës sime në turne është lëkura e zezë - latex nga Dior.

**Cila është porosia e juaj për lexuesit tanë?**
Porosia ime për të gjithë të rinjtë është shumë e thjeshtë besoni në veten tuaj dhe mos ndaloni kurrë në përpjekjet për t'i realizuar ëndrrat tuaja.

I take criticisms and reactions from fans, whom I consider to be my main critics, very seriously and I always try to improve when these criticisms are appropriate. I like to improve both, as an artist or even as a person.

**Do you have a dream venue or festival you'd like to perform at?**
There are many dream places, festivals, concerts, events and world competitions. One of these competitions that I would single out now is to participate in Eurovision.

**What's the most unusual or unexpected place you've found inspiration for a song?**
The most unusual and unexpected place I've found inspiration for a song, lyric, melody line, sentence, verse, or theme title has been while I sleeping. When I woke up I wrote or recorded myself somewhere immediately because I knew that if I didn't do this, the idea or inspiration would be gone.

**If you could collaborate with any musician, dead or alive, who would it be?**
I would really like to have had a collaboration with Michael Jackson. Additionally, my other dream collaboration is with Dua Lipa, the pride of all Albanians.

**What's your favourite karaoke song when you're not performing your music?**
The song that I prefer to sing in karaoke and live performance, outside of my repertoire, is 'Bless the Broken Road' by Rascal Flatts.

**Do you have any pre-show rituals or habits?**
I'm a Catholic highlander, and the only ritual I do before shows is to pray to Jesus.

**If you weren't a musician, what other career do you think you would have pursued?**
If I wasn't a singer and I didn't play piano and guitar, I would have pursued a career in drawing or design because I always liked art and I never get tired of art. It never exhausts me.

**If you could time travel to any musical era, what would it be?**
If I could travel back in time, it would definitely be the 80s. Everything from this period of music amazes me.

**What's your go-to comfort food when you're on tour or in the studio?**
When I'm on tour or in the studio recording, my go-to comfort food is something simple, maybe sparkling water, coffee or tea, and maybe sunflower seeds just to look "cool" and "studio guy" - 😀😀😀.

**If your life were a movie, what genre would it be and who would play you?**
If my life was a movie it would be a drama genre - 😁😁😁 just kidding. But, to play me, the best would be an actor who can also sing.

**What is your dream vacation destination to unwind after a tour?**
My dream vacation destination to unwind after a tour is Miami, Florida.

**What is the strangest or most unique musical instrument you have ever played?**
The lute.

**What is the most extravagant piece of wardrobe you wear on your your tours?**
The most extravagant piece of wardrobe I wear on my on tour is black leather - latex from Dior.

**What is your message to our readers?**
My message to all the young people is very simple; keep believing in yourself and never stop striving to make your dreams come true.

# ARTI SI URË



***Në fillim të tetorit, në katin e katërt të Hotelit Grand, në Qendrën Barabar në Prishtinë u hap ekspozita e titulluar "I Këndoj Trupit Elektrik, Armatës së Atyre që i Dua". Mbi 20 artistë të rinj me prejardhje nga komunitete të ndryshme etnike në Kosovë i shfaqën punimet e tyre në këtë ekspozitë.***

## Ekspozita - një rast unik për artistët e rinj në Kosovë

Ceremonia e hapjes i mblodhi qindra vizitorë, të cilët e patën rastin që t'i shikojnë pikturat, fotografitë dhe skulpturat e këtyre artistëve të rinj dhe premtues. Kjo ekspozitë, është një aktivitet i rëndësishëm për artistët e rinj të Kosovës. Ata u bashkuan nën ombrellën e projektit "ArtSphere", i cili ua ka mundësuar atyre që t'ua prezantojnë punimet e tyre kreative audiencës së gjerë. Projekti "ArtSphere" është një përgjigje ndaj sfidave me të cilat përballen artistët e rinj në Kosovë.

## CASA: Katalizatorë për ndryshime pozitive shoqërore

Qëllimi i projektit në fjalë është që t'i tejkalojë barrierat dhe të krijojë një ekosistem që i mbështet artistët, duke i fuqizuar ata që të veprojnë si katalizatorë për ndryshime pozitive shoqërore, thonë nga Center for Affirmative Social Action - CASA (Qendra për Veprime Shoqërore Mbështetëse), një prej organizatorëve të këtij aktiviteti. Titulli i ekspozitës "I Këndoj Trupit Elektrik, Armatës së Atyre që i Dua," është frymëzuar nga poezia "I Sing the Body Electric, the Armies of Those I Love," e poetit amerikan Ualt Uitman (Walt Whitman), në të cilën ai e ka lartësuar trupin njerëzor. Shfaqja na shtyn që ta perceptojmë trupin jo vetëm si një entitet biologjik, por si një kanavacë që e mbart kulturën, çlirimin, dashurinë, dhe konfliktin, thonë nga kjo organizatë e shoqërisë civile nga Mitrovica.




## "ArtSphere" e ushqen dialogun ndërkulturor dhe shkëmbimet akademike

Vesa Sahatçiu, kuruesja e kësaj ekspozite, e përshkroi këtë nismë si: "Një dritë të shpresës për artistët e rinj në Kosovë, duke iu ofruar atyre një platformë ku ata mund të shkëlqejnë. 'ArtSphere' e ushqen dialogun ndërkulturor dhe shkëmbimet akademike, duke e krijuar një mjedis për shprehje artistike dhe të mësuarit së bashku."

Tina Sulejmani, një nga pjesëmarrëset e kësaj ekspozite, po ashtu foli për përshtypjet e saj. Ajo u shpreh se i tërë koncepti i ekspozitës e ka bërë të ndjehet mirë që është pjesë e saj. "Kjo ishte një mundësi e mrekullueshme për të mësuar nga artistët e tjerë dhe për t'i ndarë mendimet e mia me ata," tha Tina. Ajo u shpreh mirënjohëse që kuruesja e ka përzgjedhur njërën prej pikturave të saj të preferuara për ta shfaqur në këtë ekspozitë. "Pa dyshim ajo dallonte në etikë dhe vizualisht nga punimet e tjera. Duke qenë një 'outsider' për sa i përket ndjenjave që i shpreh dhe se pikturoj siç unë dua, por që unë nuk u ndjeva si një 'outsider', por si një pjesë e tërësisë," theksoi kjo artiste e re. Ajo më tej shtoi që energjia nga kombinimi i mendësive dhe kulturave të ndryshme është e mirëseardhur dhe i kontribuon skenës artistike.

Në anën tjetër, për Milan D., një artist i ri i cili rishtas ka diplomuar në Fakultetin e Arteve në pjesën veriore të Mitrovicës, kjo ekspozitë ishte një mundësi unike për të shfaqur për herë të parë punimet e tij në Prishtinë. "Pjesëmarrja në ekspozitën 'I Këndoj Trupit Elektrik, Armatës së Atyre që i Dua,' në Qendrën barabar ishte një përvojë e çmuar. Kjo ekspozitë ishte një mundësi unike për t'i ndarë punimet e mia me një publik më të gjerë," tha Milan. Ai e shprehu kënaqësinë e tij që ishte pjesë e këtij projekti dhe shpreson

që kjo ekspozitë do t'i frymëzojë artistët e tjerë të rinj që të shprehin veten dhe të bëhen agjentë të ndryshimeve pozitive në shoqëri.

### Mbështetja e artistëve të rinj, krijimi rrjeteve dhe ndërtimi i urave

Ekspozita i bashkoi mbi njëzet artistë të rinj të komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë, me përkushtimin për të eksploruar rëndësinë kulturore të trupit njerëzor. Realizimi i kësaj ekspozite u mundësua nga Integra, CASA, dhe Qendra Barabar, me ndihmën e Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë dhe Fondit të Vëllezërve Rokfeller (Rockefeller Brothers Fund). Bashkëpunimi i Integra, Center for Affirmative Social Action – CASA, dhe Qendrës Barabar në këtë ekspozitë kishte qëllim të dyfishtë: mbështetjen e artistëve lokal, krijimin e rrjeteve, ndërtimin e urave si dhe ngritjen e vetëdijes publike dhe çmuarjen e diversitetit kulturor të Kosovës.



*Ekspozita ishte e hapur nga 4 deri më 31 tetor 2023, në Qendrën Barabar, një hapësirë unike që udhëhiqet nga një ekip i mbështetur nga UNMIK, e që është dizajnuar si një hapësirë fizike ku njerëzit e kombë sive dhe komuniteteve të ndryshme mund të bashko hen, shoqërohen, diskutojnë tema që u interesojnë, dhe mësojnë nga njëri-tjetri.*

Na vizitoni në:
Visit us at:

# ART AS A BRIDGE

***In early October, on the fourth floor of the Grand Hotel, an exhibition titled "I Sing the Body Electric, the Armies of Those I Love" was opened at the Barabar Center in Pristina. Over 20 young artists from diverse ethnic communities in Kosovo showcased their works at this exhibition.***

### The exhibition - a momentous occasion for young artists in Kosovo

Its opening ceremony drew hundreds of visitors who had the opportunity to view paintings, photographs, and sculptures by these young and promising artists. This exhibition constitutes an important event for young artists in Kosovo. The artists gathered under the umbrella of the "ArtSphere" project, enabling them to display their creative works to a wider audience. The "ArtSphere" project is a response to the challenges faced by young artists in Kosovo.

### CASA: A catalyst for positive social changes

The aim of the said project is to transcend barriers and create an ecosystem that supports artists, empowering them to act as catalysts for positive social change, as stated by the Center for Affirmative Social Action (CASA), one of the event's organizers. The exhibition's title, "I Sing the Body Electric, the Armies of Those I Love," is inspired by the work of Walt Whitman, a poet celebrating the human form. The display prompts us to perceive the body not merely as a biological entity but as a canvas bearing culture, liberation, love, and conflict, according to the civil society organization based in Mitrovica.

### "ArtSphere" nurtures intercultural dialogue and academic exchange

Vesa Sahatçiu, the curator of this exhibition, described this initiative as: "A beacon of hope for young artists in Kosovo, providing them with a platform to shine. 'ArtSphere' nurtures intercultural dialogue and academic exchange, fostering an environment for artistic expression and mutual learning."

Tina Sulejmani, a participant in the exhibition, shared her impressions. She expressed that the entire concept of the exhibition made her feel good to be part of it. "It was a great opportunity to learn from other artists and share my thoughts with them," Tina said. She expressed gratitude for having one of her favorite paintings selected by the curator to be displayed at the exhibition. "It definitely stood out ethically and visually from the rest. Being an 'outsider' in terms of what I express and paint how I want, yet I didn't feel like an 'outsider,' but rather a part of the whole," emphasized the young artist. She added that the energy of combining different mentalities and cultures is welcome and contributes to the art scene.

On the other hand, for Milan D., a young artist who recently graduated from the Faculty of Arts in the northern part of Mitrovica, this exhibition was a unique opportunity to showcase his work in Pristina for the first time. "Participating in the exhibition 'I Sing the Body Electric, the Armies of Those I Love' at the Barabar Center was a valuable experience. This exhibition provided a unique opportunity to share my work with a wider audience," Milan said. He expressed his delight in being part of this project and hopes that the exhibition will inspire other young artists to express themselves and become agents of positive change in society.

### Nurturing local artists, creating networks and building bridges

The exhibition brought together over twenty talented young artists from different ethnic communities in Kosovo, dedicated to exploring the cultural significance of the human body. The realization of this exhibition was made possible by Integra, CASA, and Barabar Center, with the support of the Swiss Office for Cooperation in Kosovo and the Rockefeller Brothers Fund. Integra, the Center for Affirmative Social Action - CASA, and the Barabar Center collaborated on this exhibition with a dual goal: nurturing local artists, creating networks, building bridges, and raising public awareness and appreciation for Kosovo's cultural diversity.

*The exhibition was open from October 4th to October 31st, 2023, at the Barabar Center, a unique space led by a team with the support of UNMIK, designed as a physical environment where people of different nationalities and communities can gather, socialize, discuss topics of interest, and learn from each other.*

# TRADITAT E VITIT TË RI NËPËR BOTË

**Ardhja e Vitit të Ri shpesh nënkupton ndjelljen e fatit dhe gëzimit. Mirëpo, hidhini një sy listës sonë më poshtë të disa prej traditave më të çuditshme dhe të mrekullueshme të natës së Vitit të Ri nëpër botë.**








## Ngrënia e 12 kokrrave të rrushit në mesnatë, Spanjë

Në Spanjë, besohet se nëse e hani një kokërr rrushi në kohë me çdo rrahje të orës në mesnatë, atëherë do të shpërbleheni me fat dhe lumturi në vitin e ardhshëm. Kjo traditë e ka origjinën në vitin 1909, kur në Spanjë pati një vjelje tejet të begatë rrushi gjatë sezonit festiv dhe Mbreti zgjodhi t'ua jepte njerëzve tepricat e prodhimit për t'i konsumuar në natën e Vitit të Ri.

## Bartja e valixhes së zbrazët, Kolumbi

Për kolumbianët është traditë që të ecin nëpër lagje në natën e Vitit të Ri me një valixhe bosh me shpresën se do të jetë një vit i mbushur me udhëtime dhe aventura.

## Thyerja e pjatave dhe kërcimi nga karriget, Danimarkë

Është zakon që danezët të festojnë natën e Vitit të Ri duke hedhur pjata dhe gota të vjetra në dyert e shtëpive të familjarëve dhe miqve të tyre për t'i larguar shpirtrat e këqij. Ata gjithashtu ngrihen bashkë në këmbë në karrige dhe kërcejnë prej tyre në mesnatë për të 'kaluar' në janar me shpresën për fat të mirë.

## Interpretimi i formave të metalit, Finlandë

Në Finlandë, besohet se njerëzit janë në gjendje të parashikojnë vitin e ardhshëm duke hedhur kallaj të shkrirë në një enë me ujë dhe më pas duke e interpretuar formën që metali e merr pasi ngurtësohet. Sipas traditës, një zemër ose një unazë do të thotë një martesë, ndërsa forma e një anijeje parashikon udhëtim. Besohet gjithashtu se nëse e shihni formën e një derri, atëherë do të keni një vit të mbushur me ushqim të bollshëm.

## Djegia e shëmbëlltyrave, Panama

Në Panama është traditë që njerëzit të largojnë shpirtrat e këqij duke djegur shëmbëlltyra (muñecos) të njerëzve të njohur si personazheve televizive dhe figurave politike të vendit. Shëmbëlltyrat e përfaqësojnë vitin e vjetër, duke i lejuar kështu njerëzit që të kenë një fillim të mbarë të Vitit të Ri.

**Hedhja e gjësendeve të vjetra, Afrikë e Jugut**
Është traditë që banorët e Johanesburgut të festojnë fort duke i hedhur aparatet dhe pajisjet e vjetra nga dritarja, duke e përqafuar fjalë për fjalë shprehjen "jashtë të vjetrën dhe brenda të renë".

**Forma të rrumbullakëta, Filipine**
Në natën e Vitit të Ri, do të gjeni një shumëllojshmëri formash të rrumbullakëta në tërë Filipinet, të cilat i simbolizojnë monedhat. Thuhet se ato e ndjellin begatinë në vitin e ardhshëm. Nga veshja e rrobave me pika për fat, deri tek shërbimi i grumbujve me fruta të rrumbullakosura në tavolinat e tyre të ngrënies, është pothuajse e pamundur t'iu shpëtosh atyre!

**Qepë të varura, Greqi**
Në Greqi, është traditë që të varet një qepë në derën e përparme të shtëpisë në natën e Vitit të Ri si një simbol i rilindjes në Vitin e Ri. Për nder të ditës së Vitit të Ri, prindërit i zgjojnë më pas fëmijët e tyre duke i prekur në kokë me qepë.

**Të hahet shumë, Estoni**
Tradicionalisht, në ditën e Vitit të Ri, estonezët përpiqen të hanë shtatë, nëntë ose dymbëdhjetë herë gjatë ditës, pasi të gjithë këta janë numra me fat. Besohet se sa më shumë të hanë, aq më shumë ushqim do të kenë gjatë vitit.



# NEW YEAR'S EVE TRADITIONS AROUND THE WORLD

**The coming of a new year often means the bringing about of good luck and fortune. But take a look at our list below of some of the world's most weird and wonderful New Year's Eve traditions.**

**Eating 12 grapes at midnight, Spain**
In Spain, it is believed that if you eat one grape in time with each chime of the clock at midnight, then you will be rewarded with luck and happiness in the coming year. This tradition originated back in 1909, when there was a huge grape harvest in the country during the festive season, and the King chose to give the surplus of produce to the people to consume on New Year's Eve.

**Carrying empty suitcases, Colombia**
In a hope for a year filled with travel and adventure, it is a tradition for Colombian residents to walk around the block on New Year's Eve with an empty suitcase.

**Smashing plates and jumping off chairs, Denmark**
It is customary for residents of Denmark to celebrate New Year's Eve by throwing old plates and glasses against the doors of their family and friends to banish bad spirits. They also collectively stand on chairs and jump off them at midnight to 'leap' into January in hopes of good luck.

**Interpreting metal shapes, Finland**
In Finland, it is believed that people are able to predict the coming year by casting molten tin into a container of water, and then interpreting the shape the metal takes after it hardens. According to the tradition, a heart or a ring means a wedding, while the shape of a ship predicts travel. It is also believed that if you see the shape of a pig then you will have a year filled with plenty of food.

**Burning effigies, Panama**
It is tradition for people in Panama to drive off evil spirits by burning effigies (muñecos) of well-known people such as TV characters and political figures in Panama. The effigies are meant to represent the old year, therefore allowing people to start with a fresh New Year's start.

**Throwing out the old, South Africa**
It is a tradition for residents in Johannesburg to party hard by throwing old appliances and equipment out of the window, literally representing the adage 'out with the old and in with the new.'

**Round shapes, Philippines**
On New Year's Eve, you'll find a variety of round shapes all over the Philippines, representing coins. They are said to symbolise prosperity in the coming year. From wearing polka dots for luck, to displaying piles of rounded fruit on their dining tables, it's almost impossible to escape them!

**Hanging onions, Greece**
In Greece, it is traditional to hang an onion on the front door of your home on New Year's Eve as a symbol of rebirth in the New Year. To commemorate New Year's Day, parents then wake their children by tapping them on the head with the onion.

**Eating lots, Estonia**
Traditionally, on New Year's Day, Estonians try to eat seven, nine or twelve times throughout the day, as these are all lucky numbers. It is believed that the more they eat, the more plentiful food will be coming in the year.





# SI TË BËJMË NJË ZBUKURIM BREDHI NGA SHKOPINJTË E AKULLOREVE?

*Është muaji dhjetor... magjinë e atmosferës festive mund ta shohim dhe ndiejmë kudo rreth nesh. Në shumë shtëpi në mbarë botën, zbukurimi i bredhit është një traditë. Prandaj, punohen edhe zbukurime për bredhin, për të zbukuruar dhe pasuruar atmosferën gjatë festave të fundvitit.*

*Zbukurimet prej letre, druri, leshi, ato nga materialet e ricikluara janë vetëm disa nga zbukurimet që mund t'i bëni vetë në shtëpi. Në të vërtetë, ekzistojnë një sërë idesh krijuese që mund t'i provoni ose t'i përshtatni me stilin tuaj personal për të krijuar zbukurime unike për bredh. Këto zbukurime të punuara me dorë shpesh i japin një hije të veçantë dekorit të festave. Në vijim mund të lexoni se si të bëni një sajë zbukuruese për bredhin nga shkopinjtë e akulloreve.*

## Materiali i nevojshëm

- *shkopinj akulloresh (2 të gjatë dhe 5 të shkurtër)*
- *ngjitës*
- *ngjyrë mbrojtëse për dru*
- *ngjyrë*
- *litar nga pambuku*
- *ngjitës "stick" (në formë të buzëkuqit)*
- *zbukurime sipas dëshirës (ne këtu i kemi përdorur dy zile, pak pemë artificiale të bardhë dhe litar nga pambuku)*
















## Procesi i punimit

**1** *Fillimisht ngjitni së bashku 4 shkopinjë të shkurtër. Lëshoni dy shkopinjtë anësor pak më poshtë. Mënyra më e lehtë për të aplikuar ngjitësin është që të hidhni pak ngjitës në pjatë dhe më pas me përdorimin e një rrëmojce ta aplikoni ngjitësin përgjatë skajeve. Pastaj lëreni të thahet.*

**2** *Më pas lyeni shkopinjtë e vegjël me ngjyrën që dëshironi. Ne këtu zgjodhëm të kuqen. Lini të thahen. Tani lyeni shkopinjtë e gjatë. Pasi t'i ngjyrosni, dy shkopinjtë e gjatë ngjitni me shkopinjtë më të vegjël, siç është pasqyruar në fotografi. Vetëm për t'ua kujtuar, është shumë më e lehtë të aplikoni ngjitësin nëse e përdorni një rrëmojcë. Mbetet vetëm të ngjitni tërthoraz shkopin e fundit në pjesën e përparme të sajës.*

**3** *Shtoni zbukurimet e dëshiruara. Këtu kemi përdorur disa degë pemësh artificiale të bardha, të cilat i kemi mbështjellë me litar pambuku dhe më pas ua kemi varur disa zile të vogla. Litarin e kemi lidhur rreth shkopit të tërthortë në sajë. Nëse dëshironi, mund të dekoroni sajën duke e shkruar emrin tuaj ose vitin në të. Madje i kam parë disa duke e shtuar një fotografi në sajë.*

**4** *Në fund, prejeni një litar apo spango të zakonshme, në gjatësinë që ju përshtatet dhe ngjiteni në pjesën e poshtme të shkopit të tërthortë me ndihmën e ngjitësit "stick".*

***Kjo sajë e vogël duket e lezetshme e varur në bredh, por nëse e përdorni pak imagjinatën tuaj, mund të përdoret në shumë mënyra të tjera. Gjersa është shumë e lehtë dhe e thjeshtë për t'u punuar.***

***(Burimi: https://www.cleanandscentsible.com)***



# HOW TO MAKE A CHRISTMAS TREE DECORATION FROM POPSICLES?

*It is December... We can see and feel the magic of the festive atmosphere all around us. In many homes around the world, decorating the Christmas tree is a tradition. Therefore, decorations for the New Year tree are also made, in order to beautify and make the atmosphere during the holiday season.*

*Decorations made of paper, wood, wool, but also those made of recycled materials are just some of the decorations you can make yourself at home. Indeed, there are a variety of creative ideas that you can try or adapt to your own personal style to create unique Christmas decorations. These handmade decorations often add a special touch to the holiday decor. Below, read how to make a decoration sled for the New Year's tree from popsicles.*

## Necessary material

- *popsicle {craft} sticks (2 regular sized and 5 small per sled)*
- *wood glue*
- *wood stain*
- *paint*
- *twine*
- *glue dots*
- *embellishments if desired (I used a couple of jingle bells, some faux flocked greenery, and baker's twine)*






## The making process




1 *First it is necessary to glue 4 of the small craft sticks together staggering the end stick on each side slightly lower. I found the easiest way to apply the glue for this project was to squirt some glue out onto a paper plate and then use a large toothpick or skewer to apply the glue along the edges. Allow to dry.*



2 *Then paint the smaller popsicles in the color of your choice. We chose red here. Leave to dry. Now paint those plain popsicles. Now glue the colored popsicles to the smaller popsicles as shown in the picture. Just to remind you, it is much easier to apply the glue if you use a toothpick. All that's left is to glue the cross bar to the front of the sled.*



3 *Add whatever embellishments you would like. I took a few little sprigs of faux greenery, wrapped them in baker's twine, and then threaded on a couple of small jingle bells. I then just tied the baker's twine around the cross bar. If you want you can decorate the sled by writing your name and year on it. I've even seen some that add a photo to the sled.*




4 *In the end cut some regular twine to your desired length and attach to the underside of the cross bar using glue dots.*

***This little sled looks cute hanging from the Christmas tree, but if you use a little imagination, it can be used in many other ways. And they can be made so easily and simply.***

**(Source: https://www.cleanandscentsible.com)**

MOVIEMANIA

# FILMAT E RI NË MUAJIN DHJETOR 2023

***Si gjithmonë, dhjetori është një muaj i gëzueshëm për entuziastët e filmit, duke e ofruar një gamë të gjerë të publikimeve të shumëpritura që janë të dedikuara të zbukurojnë ekranet e argjendta. Nga rrëfimet emocionuese të dashurisë dhe të të qeshurave deri tek aventurat emocionuese, formacioni kinematografik i këtij muaji me siguri do të magjeps shikuesit e të gjitha moshave. Me fillimin e sezonit të festave, shikuesit e filmave mund të presin me padurim një gamë të larmishme filmash, që premtojnë t'i shpiejnë ata në udhëtime magjike, të frymëzojnë harenë festive dhe të ndezin imagjinatën e audiencës në mbarë botën. Më poshtë mund të gjeni disa sugjerime që besojmë se do t'ju pëlqejnë.***




## CANDY CANE LANE

Eddie Murphy luan në këtë film festash të zhanrit aventurë/ komedi, në rolin e një burri në mision për të fituar garën vjetore për dekorimin më të mirë të shtëpisë për Krishtlindje në lagjen e tij. Pasi Kris (Eddie Murphy) pa dashje, për të përmirësuar shanset e tij për të fituar, bën një marrëveshje me një kukudh djallëzor të quajtur Pepër (Jillian Bell), ajo e hedh një magji që i sjell 12 Ditët e Krishtlindjeve në jetë dhe shkakton kërdi në të gjithë qytetin. Përkundër rrezikut që të prish festat për familjen e tij, Krisi, gruaja e tij Keroll (Tracee Ellis Ross) dhe tre fëmijët e tyre duhet të garojnë kundër kohës për të thyer magjinë e kukudhit Pepër, të luftojnë kundër personazheve djallëzore magjike dhe për të shpëtuar Krishtlindjen për të gjithë.




## HOW THE GRINGO STOLE CHRISTMAS

Filmi ndjekë Benin (George Lopez), i cili mezi pret ardhjen e vajzës së tij Claudia (Emily Tosta) në festën e tij të Krishtlindjeve meksikane-hispanke-amerikane-çikane në Los Agjelosin Lindor. Por Beni sa nuk pëson sulm në zemër nga befasia kur Claudia shfaqet nga Nju Jorku me të dashurin e saj të ri, Leif (Jack Kilmer), një




## TEDDY'S CHRISTMAS

Gjatë një vizite në Tregun e Krishtlindjes në qytetin e saj norvegjez, Mariana tetë vjeçare e sheh papritur një pamje të pabesueshme: në raftin e sipërm të një tezge lojërash tek parku i lojrave, arushi më i adhurueshëm nga pelushi e lëviz kokën dhe teshtinë. Duke e ndjerë një lidhje të menjëhershme me kafshën e gjallë nga pelushi, Mariana nuk mund të mendojë për ndonjë dëshirë më të mirë për Krishtlindje sesa ta fitojë atë si çmim. Por, kur dikush tjetër e fiton Tedin, i takon arushit dhe mikut të tij të ri, iriqit të quajtur Bolla, të rilidhen me Marianën dhe të zbulojnë rëndësinë e vërtetë të familjes dhe miqësisë.



gringo i paftuar. Ndërsa kulturat përplasen, kremta e festave e Benit bëhet një Krishtlindje e paharrueshme familjare jofunksionale.

**WONKA**
Libri "Charlie and the Chocolate Factory" i vitit 1964 nga Roald Dahl është një nga librat më ikonik për fëmijë. Ai u adaptua në film në vitin 1971, ku në rolin kryesor si Wonka luajti Gene Wilder. Një adaptim më i ri me të njëjtin emër si libri u publikua në vitin 2005, në të cilin film Johnny Depp u paraqit si Wonka. Këtë dhjetor, adhuruesit e çokollatëbërësit të çuditshëm mund të shijojnë filmin Wonka, pararendësin e historisë së librit, i cili tregon se si Willy Wonka u shndërrua nga një djalosh i ri që shiste çokollatë në një dyqan të vogël karamelesh, në një gjeni eksentrik të njohur në mbarë botën. Timothée Chalamet e luan rolin kryesor në këtë film.




# DECEMBER 2023 MOVIE RELEASES

***As always, December is a merry month for movie enthusiasts, offering an eclectic mix of highly anticipated releases that are set to grace the silver screen. From heartwarming tales of love and laughter to pulse-pounding adventures, this month's cinematic lineup is sure to captivate audiences of all ages. As the holiday season rolls in, moviegoers can look forward to a diverse array of films, promising to whisk viewers away on magical journeys, inspire festive cheer, and spark the imaginations of audiences worldwide. Below you can find a few suggestions we believe you will like.***

## TEDDY'S CHRISTMAS
While visiting a Christmas market in her Norwegian town, eight-year-old Mariann suddenly sees an unbelievable sight: on the top shelf of a carnival game booth, the most adorable stuffed teddy bear has just moved his head and sneezed. Feeling an instant connection with the living stuffed-animal, Mariann can't think of any better Christmas wish than to win him as a prize. But when someone else wins Teddy, it's up to him and his new hedgehog friend, Bolla, to reconnect with Mariann and discover the true importance of family and friendship.

## CANDY CANE LANE
Eddie Murphy stars in this holiday comedy adventure about a man on a mission to win his neighborhood's annual Christmas home decoration contest. After Chris (Eddie Murphy) inadvertently makes a deal with a mischievous elf named Pepper (Jillian Bell) to better his chances of winning, she casts a magic spell that brings the 12 Days of Christmas to life and wreaks havoc on the whole town. At the risk of ruining the holidays for his family, Chris, his wife Carol (Tracee Ellis Ross), and their three children must race against the clock to break Pepper's spell, battle deviously magical characters, and save Christmas for everyone.

## HOW THE GRINGO STOLE CHRISTMAS
The film follows Bennie (George Lopez), who's eagerly anticipating the arrival of his daughter Claudia (Emily Tosta) at his Mexican-Hispanic-American-Chicano Christmas party in East L.A. But Bennie gets a heart attack of a surprise when Claudia appears from New York with her new boyfriend, Leif (Jack Kilmer) an uninvited gringo. As cultures clash, Bennie's holiday party becomes a dysfunctional family Christmas to remember!

## WONKA
The 1964 Charlie and the Chocolate Factory by Roald Dahl is one of the most iconic children's books. It was adapted into a movie in 1971 starring Gene Wilder as Wonka. A newer adaptation with the same name as the book was released in 2005, in which Johnny Depp starred as Wonka. This December, fans of the eccentric chocolatier can enjoy the movie Wonka, a prequel to the book story, which tells how Willy Wonka went from a young adult selling chocolate in a small candy store to an eccentric genius known all over the world. The film stars Timothée Chalamet in the title role.

# JUDE BELLINGHAM

## ADOLESHENTI SENSACIONAL QË E PO E PUSHTON ME VRULL REAL MADRIDIN

***Në botën emocionuese të futbollit, një yll i ri i ka pushtuar kryetitujt e revistave dhe emri i tij është Jude Bellingham. Ndonëse vetëm 20 vjeçar, ky mesfushor anglez tashmë ka lënë gjurmë të pashlyeshme në peizazhin futbollistik. Udhëtimi i Bellingham nga Birmingham City në Borussia Dortmund, dhe tani në fanellën ikonike të bardhë të Real Madrid, nuk është asgjë më pak se spektakolar.***



### Shkëlqimi i hershëm: Një yll në ngritje në Birmingham City

Odiseja e futbollit të Bellingham filloi në akademinë e të rinjve të Birmingham City kur ai ishte vetëm tetë vjeç. Ylli i ri u ngrit shpejt nëpër nivelet e klubit, duke e tërhequr vëmendjen e të gjithëve kur debutoi si senior kur i kishte vetëm 16 vjet e 38 ditë. Lojtari më i ri i ekipit të parë të Birmingham City, Bellingham e shfaqi talentin e tij, duke shënuar gola vendimtarë dhe duke u bërë një fener shprese për klubin. Në vlerësim të asaj që Bellingham arriti në një kohë aq të shkurtër me ekipin e parë, klubi e ka bërë të ditur se do ta pensionojnë fanellën me numrin 22 "për të kujtuar një prej neve dhe për të frymëzuar të tjerët".

### Aventura e Borussia Dortmund: Një adoleshent në qendër të vëmendjes së Bundesligës

Kapitulli tjetër i rrugëtimit të Bellingham u shpalos në Bundesligën gjermane me Borussia Dortmundin, e njohur për edukimin dhe zhvillimin e talenteve të rinj. Pasi iu bashkua gjigantëve gjermanë në vitin 2020, ai u bë një sensacion i menjëhershëm, duke thyer rekorde dhe duke fituar çmime. Paraqitjet e tij në sezonin 2022-23 ia sollën atij çmimin Lojtari i Sezonit në Bundesligë, duke e lënë një trashëgimi të qëndrueshme në fanellën verdhezi të Dortmundit.

### Trofeu Kopa dhe ëndrra e Real Madridit: Kryexhevahiri në karrierën e Bellingham

Në vitin 2023, zotësia e Bellingham në fushë u njoh globalisht teksa ai e fitoi trofeun prestigjioz Kopa, një çmim nderi që i jepet futbollistit mashkull nën 21 vjeç me performancën më të mirë. Përpara fitimit të këtij trofeu, një ëndërr u bë realitet kur Real Madridi i siguroi shërbimet e tij për shumën marramendëse prej 103 milionë euro, e cila mund të shkoj në gati 133.9 milionë euro për shkak të shtesave, të cilat mund të arrijnë në 30% të shumës fikse të transferimit. Duke folur për arsyen pse u bë pjesë e Real Madridit, Bellingham përmendi se "respekti që Anglia e ka për Real Madridin është tejet i lartë" dhe se ai donte të ishte një nga lojtarët që do ta pasuronte "këtë histori të lavdishme". Ai gjithashtu e pranoi se "sa nuk i ndaloi zemra" kur i treguan se klubi spanjoll dëshironte të nënshkruante kontratë me të. Për më tepër, me të mbërritur në Real Madrid atij iu dha fanella me numrin "5", e cila u bë e pavdekshme nga hiq më pak se legjenda moderne e Real Madridit, Zinedine Zidane. Lidhur me këtë, Bellingham ka deklaruar se është një nder dhe krenari e madhe që e vesh këtë fanellë pasi u rrit duke e parë Zidanin si idhullin e tij.

### Debutimi në Real Madrid: Gola pafund dhe arritje historike

Ardhja e Bellingham në Real Madrid nuk ka qenë asgjë më pak se sensacionale. Ai e ka përqafuar me elegancë fanellën e bardhë ikonike nga shënimi



në debutimin e tij para-sezonal e deri te shënimi i golave të rëndësishëm në La Liga dhe në Ligën e Kampionëve. Një ndryshues i vërtetë i lojës, ndikimi i Bellingham është ndjerë në të gjithë botën e futbollit.

### *Fama ndërkombëtare: Maestro i ri i anglisë*

Ndërsa paraqitjet e tij në klub janë një spektakël, Bellingham ka lënë gjurmë të pashlyeshme edhe në skenën ndërkombëtare. Nga debutimi i tij për ekipin e seniorëve të Anglisë në moshën 17 vjeç e 136 ditë deri në shënimin e golave vendimtarë në Kupën e Botës 2022, ai e mishëron të ardhmen e futbollit anglez.

### *Stili dhe përbërja: Mesfushori i kompletuar*

I njohur për kontrollin e tij të jashtëzakonshëm të topit, aftësitë fizike dhe finesën teknike, Bellingham e ka fituar reputacionin se është një prej mesfushorëve të rinj më të mirë në botë. Festimi i golave me kokën lart, duart e hapura dhe gjoksin para, është kthyer në një simbol të vetëbesimit dhe dominimit të tij në fushë.




***Në peizazhin e futbollit ku rinia është zemra e lojës, Jude Bellingham qëndron lart, duke shfaqur jo vetëm aftësi, por edhe qëndrueshmëri dhe vendosmëri. Ndërsa ai vazhdon të shkruajë emrin e tij në librat e historisë së futbollit, një gjë është e qartë - Jude Bellingham është një emër që do ta brohorasim për vite me radhë.***

# JUDE BELLINGHAM

## THE TEEN SENSATION TAKING REAL MADRID BY STORM

***In the thrilling world of football, a young star has been making headlines, and his name is Jude Bellingham. At just 20 years old, this English midfielder has already left an indelible mark on the footballing landscape. Bellingham's journey from Birmingham City to Borussia Dortmund, and now to the iconic white jersey of Real Madrid, is nothing short of spectacular.***

### *Early brilliance: A rising star at Birmingham City*

Bellingham's football odyssey began at Birmingham City's youth academy when he was just eight years old. The young prodigy quickly rose through the ranks, catching everyone's attention when he made his senior debut at a mere 16 years and 38 days. Birmingham City's youngest-ever first-team player, Bellingham showcased his talent, scoring crucial goals and becoming a beacon of hope for the club. In appreciation of what Bellingham achieved in such a short time with the first team, the club announced that they would retire his number 22 shirt, "to remember one of our own and to inspire others."

### *Borussia Dortmund adventure: A teenager in the Bundesliga spotlight*

The next chapter of Bellingham's journey unfolded in the German Bundesliga with Borussia Dortmund renown for nurturing and development of young talents. Joining the German giants in 2020, he became an instant sensation, breaking records and earning accolades. His performances in the 2022-23 season earned him the Bundesliga Player of the Season award, leaving a lasting legacy in Dortmund's yellow and black jersey.

### *Kopa Trophy and Real Madrid dream: The crown jewel in Bellingham's career*

In 2023, Bellingham's prowess on the pitch was globally recognized as he clinched the prestigious Kopa Trophy, an honor bestowed upon the best-performing male footballer under 21. Prior to winning this trophy, A dream became reality when Real Madrid secured his services for a staggering €103 million which could potentially increase to approximately €133.9 million due to add-ons, which can amount to 30% of the fixed transfer amount. Speaking of why he joined Real Madrid, Bellingham mentioned that the "respect that England has for Real Madrid is so high", and that he wanted to be one of the players that would add to its "great history". He also admitted that his "heart was close to stopping" when he was told that the Spanish club wished to sign him.

Moreover, upon arriving at Real Madrid he was given the number "5" jersey, which was made immortal by none other than Real Madrid modern legend Zinedine Zidane. In relation to this, Bellingham has stated that it is with great pride he wears this jersey as he grew up watching Zidane as he was his idol.

### *Real Madrid debut: Goals galore and historic achievements*

Bellingham's arrival at Real Madrid has been nothing short of sensational. From scoring in his pre-season debut to netting crucial goals in La Liga and the Champions League, he has embraced the iconic white shirt with flair. A true game-changer, Bellingham's impact has been felt across the footballing world.

### *International stardom: England's young maestro*

While his club performances are a spectacle, Bellingham has also left an indelible mark on the international stage. From his debut for the England senior team at 17 years and 136 days to scoring crucial goals in the 2022 World Cup, he embodies the future of English football.

### *Style and substance: The complete midfielder*

Known for his exceptional ball control, physical prowess, and technical finesse, Bellingham has earned a reputation as one of the world's best young midfielders. His goal celebration, head held high arms stretched and chest out, has become a symbol of his confidence and dominance on the field.

***In a footballing landscape where youth is the heartbeat of the game, Jude Bellingham stands tall, showcasing not just skill but also resilience and determination. As he continues to etch his name in the annals of football history, one thing is clear — Jude Bellingham is a name we'll be cheering for years to come.***

# A ËSHTË 'BEREAL' AI I VËRTETI?
## Një vështrim në botën e autenticitetit




***Në ekosistemin e pafund të aplikacioneve të mediave sociale, një aplikacion i ri është duke fituar popullaritet tek adoleshentët në mbarë botën. Për të gjithë ata të cilët ende nuk kanë njohuri për këtë aplikacion, një përshkrim i shkurtër do të ishte se ky aplikacion i ri i mediave sociale merr pak nga të gjitha mediat sociale më të popullarizuara, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, "Facebook", "Instagram", "Snapchat", etj. Për më tepër, në të njëjtën kohë, ky aplikacion synon të shmangë shumë probleme që lidhen me aplikacionet e lartpërmendura, si përdorimi i filtrave për paraqitjen e fotove falso, kohën e tepërt të shpenzuar në lëvizje, etj.***

**Ji i i vërtetë, ji vetvetja!**
Siç është përmendur tashmë, "BeReal" nuk është aplikacioni juaj tipik; ai është bileta juaj në prapaskenën e jetës reale! Një fotografi e pafiltruar dhe e pa redaktuar e kënaqësisë suaj të përditshme e bërë njëkohësisht nga kamera e përparme dhe ajo e pasme e telefonit tuaj, që ndahet brenda një kohe të shkurtër dyminutëshe. Pa fasada, pa filtra, vetëm jetë, e papërpunuar dhe e vërtetë! Tingëllon "cool", apo jo?

**Pritni pak këtu**
Ashtu si çdo gjë tjetër që lidhet me internetin, pavarësisht se synon të shmangë shumë nga rreziqet që mund të sjellë përdorimi i mediave ekzistuese sociale, "BeReal" gjithashtu vuan nga disa rreziqe. Prandaj, më poshtë mund të lexoni pak më shumë se cilat janë të mirat dhe jo aq të mirat e aplikacionit "BeReal".

**TË MIRAT**
**Mbingarkesë e autenticitetit**
Nuk ka filtra? Ky është emri i lojës! Kjo do të thotë të mos shqetësoheni për postimet e përsosura. "BeReal" e lartëson bukurinë e momenteve reale.

**Lidhuni dhe komunikoni**
Ikonat "RealMojis" janë në dispozicion për të krijuar komunikim të thjeshtë. Përdorni këto ikona të vogla argëtuese për të reaguar ndaj fotografive të miqve tuaj dhe kridhuni në një bisedë "cool", ashtu si edhe në platformat e tjera.

**Grimca të shpejta argëtimi**
Thuaj lamtumirë "scrolling" të pafund. "BeReal" është një aplikacion kundër "scrolling"; kjo do të thotë se ai i mban gjërat shkurt, ëmbël dhe tejet argëtuese.

**TË KËQIJAT**
**Biznes i rrezikshëm**
Me lirinë vjen edhe përgjegjësia. Kini parasysh se ekziston një mundësi e vërtetë që disa postime të mos jenë të përshtatshme për të gjithë. Prandaj, duhet të jeni vazhdimisht vigjilent për një përmbajtje të tillë dhe të bëni përpjekje për ta bllokuar ose shmangur plotësisht atë. Nëse nuk dini si, mos hezitoni të kërkoni ndihmë nga familja juaj.

**Vendndodhja, vendndodhja, vendndodhja**
Vendndodhja juaj mund të jetë publike! Kjo për shkak se funksioni i vendndodhjes gjeografike (lokacionit) është i aktivizuar si parametër standard (default). Rrjedhimisht, kjo do të thotë se vendet ku






ju rrini mund të shfaqen. Kjo nuk është mirë nëse të panjohurit ia hedhin një sy. Megjithatë, lajmi i mirë në këtë drejtim është se ky parametër mund të çaktivizohet.

**Ups! E humbët mundësinë!**
Nëse e humbni mundësinë (dritaren) 2-minutëshe, mund ta postoni foton tuaj edhe më vonë. Megjithatë, "BeReal" do t'ua shtyjë fotografinë tuaj të postuar miqve tuaj me një njoftim se ju e keni humbur mundësinë e përmendur. Kjo është si një zile për 'vonesë' në shkollë, por për fotografi. Kjo mund të ushtrojë presion mbi ju si përdorues për të postuar fotografinë tuaj brenda kornizës kohore të caktuar, e cila mund të përkojë me aktivitete të tjera si orët mësimore, kohën tuaj të mësimit, etj. Nëse është kështu, nuk duhet t'i jepni përparësi kësaj kohe për mundësi postimi pasi që mund t'ju vërë në telashe me mësuesit dhe/ose prindërit tuaj, ose mund të zbuloni pa dashje informacione private që nuk dëshironi t'i ndani me të tjerët.

### *Cili është vlerësimi përfundimtar?*

*Fryma e veçantë dhe spontane e "BeReal" është një freski në universin e mediave sociale. Është si një dozë ditore e realitetit të sinqertë që është argëtuese por e shkurtër. "BeReal" mund të jetë shoku i juaj i ri më i mirë, por si të gjitha gjërat interesante në jetë, edhe ai vjen me një paralajmërim për kujdes. Ndërsa i përshkoni veçoritë e tij unike, mbani mend, të jeni sa më real është kënaqësi, por edhe siguria është e mirë! Tani për tani, shijoni udhëtimin në "BeReal" me një dozë të ndërgjegjësimit. Fotografoni, shpërndajeni, por kini kujdes!*

*Mbani mend, "BeReal, BeYou"!* 📷

# IS 'BEREAL' THE REAL DEAL?
## A peek into the world of authenticity

*In the vast ecosystem of social media apps, a new app has been growing in popularity with teenagers across the world. For all those that are 'still' unfamiliar with this app, a brief description would be that this new social media app takes a little bit from all of the most popular social media including but not limited to Facebook, Instagram, Snapchat, and so on. Moreover, at the same time, this app aims to avoid many problems related to the aforementioned apps such as the use of filters to present fake photos, too much time spent scrolling, and so on.*

**Be Real, Be You!**
As already mentioned, BeReal isn't your typical app; it's your backstage pass to real life! One unfiltered, unedited snapshot of your daily groove taken simultaneously from the front and back camera of your phone that is shared within a tiny two-minute window. No facades, no filters, just life, raw and real. Sounds cool, right?

**Let's hit the pause button**
As with anything else that is Internet related, despite aiming to avoid many of the risks that the use of existing social media might bring, BeReal too suffers from certain risks. Therefore, below you can read a little bit more about what is positive and what is not so positive about BeReal.

**POSITIVES**
**Authenticity overload**
No filters? That's the name of the game! This means no worrying about picture-perfect posts. BeReal celebrates the beauty of real moments.

**Connect and communicate**
RealMojis are available to establish simple communication. Use these fun little icons to react to your buddies' photos and slide into some cool conversation, just like you do on other platforms.

**Quick bites of fun**
Say goodbye to endless scrolling. BeReal is an anti-scroll app; this means that it keeps things short, sweet, and so entertaining.

**NEGATIVES**
**Risky business**
With freedom comes responsibility. Be aware that there is a real chance for some posts not to be appropriate for everyone. Therefore, you should be constantly alert for such content and make efforts to block or avoid it completely. If you do not know how, do not hesitate to ask for help from your family.

**Location, location, location**
Your location could be public! That is because the geo-location feature is enabled by default. Consequently, this means your hangout spots might be on display. Not cool if strangers peep in. The good news on this front, however, is that this feature can be disabled.

**Oops! Missed the window**
If you miss the 2-minute window, you can still post your photo at a later time. However, BeReal will push your posted photo to your friends with a notification that you have missed the said window. That's like a 'late' bell in school but for photos. This might put some pressure on you as a user to post your photo within the given time frame, which might coincide with other activities such as school classes, your studying time, etc. If that is the case, you should not prioritize this posting time window as it may land you in trouble with your teachers and/or parents or you might unintentionally reveal private information you do not want to share with others.

### *What's the final take?*

*BeReal's quirky, spontaneous vibe is like a breath of fresh air in the social media universe. It's like a daily dose of candid reality that's fun yet brief. BeReal can be your new BFF, but like all cool things in life, it comes with a caution sign. As you walk the tightrope of its unique features, remember, keeping it real is fun, but safety's cool too! For now, enjoy the BeReal ride with a sprinkle of mindfulness. Snap, share, but be aware!*

*Remember, BeReal, BeYou!* 📷

# LUNDRIMI NË EPOKËN DIGJITALE
## *RËNDËSIA E VERIFIKIMIT TË INFORMACIONIT*

***Rëndësia e shpikjes së medieve sociale është thjesht marramendëse. Këto platforma ua kanë mundësuar njerëzve të krijojnë rrjete globale bashkëpunimi, të rivendosin lidhjet me shoqërinë e fëmijërisë ose anëtarët e largët të familjes, të fitojnë para të mëdha, të marrin informacion të shpejtë për ngjarje dhe lajme nga e gjithë bota, dhe lista nuk ka të ndalur.***




### 'Mallkimi' i medieve sociale

Megjithatë, të gjitha përfitimet vijnë me një 'çmim' ose, thënë më mirë, 'rrezik'. Rreziku se informacioni në të cilin kemi qasje nuk është i konfirmuar, dhe rrjedhimisht mund të jetë i gabuar, i njëanshëm ose në rastin më të keq drejtpërdrejtë qëllimkeq për të përhapur lajme të rreme dhe panik të panevojshëm.

Në krahasim me kohën e prindërve tanë, burimi i informacionit të të cilëve ishin medie të ndryshme që e informonin publikun në përputhje me një sërë rregullash që ishin në fuqi për të garantuar vërtetësinë, saktësinë dhe integritetin e lajmeve të tyre, tani është në duart tona për t'u siguruar se lajmet që i lexojmë janë të vërteta dhe të sakta. Aq më tepër nëse vendosim ta ndajmë lajmin e përmendur me të afërmit apo miqtë tanë. Sepse, nëse nuk e bëjmë këtë, ne e mundësojmë përhapjen e ***DIZINFORMIMIT.***

### Një mësim nga një postim në Facebook

Për t'i dhënë një kuptim më të mirë kësaj çështjeje, ne do të ndajmë një përvojë të kohëve të fundit me një postim në Facebook që shumica prej jush e keni parë tashmë dhe që për fat të mirë nuk ka pasur ndonjë efekt serioz, përveç faktit se e ka forcuar besimin në teoritë konspirative dhe e ka shfrytëzuar shqetësimin e publikut për privatësinë dhe sigurinë në internet. Po flasim për postimin që u bë mjaft viral në vitin 2019 dhe së fundmi është rishfaqur sërish. Ndonëse ideja e përgjithshme është e njëjtë, postimi i rishfaqur e përmban tekstin në vijim: ***"Këtë po e bëjnë tani, ishte lajmi që u plasua në lajmet e kanalit 4. Nga e hëna, Facebook do të tarifojë të gjithë përdoruesit. Ju mund të zgjidhni ta bëni këtë. Prekni dhe mbani këtë mesazh dhe kopjojeni atë. Nuk mund të ndahet. Unë nuk i jap leje Facebook-ut për të tarifuar 4,99 dollarë 'timeline-in' tim; të gjitha fotot e mia jane pronë e imja dhe JO e Facebook-ut!!! Falënderime të veçanta për Larryn për këtë këshillë ligjore... dhe Tim Barker për postimin e informacionit: për shkak se të gjithë po rrëmbehen lehtësisht, ata po rrëmbehen, jo hakohen, llogaritë tona po rrëmbehen tani edhe më shumë. Vetëm sepse një avokat na këshilloi ta postonim këtë. Shkelja e privatësisë mund të dënohet me ligj. SHËNIM: Facebook Meta tani është një entitet publik. Të gjithë anëtarët duhet të postojnë një shënim si ky. Nëse nuk e publikoni një të tillë, kjo teknikë lejon që fotot të jenë të dukshme, përfshirë edhe informacione që nuk gjenden në statusin e profilit tuaj. UNË NUK I JAP LEJE FACEBOOK-ut TË PËRDORË TË DHËNAT E MIJA PERSONALE.***


September 15

Edhe unë po çaktivizohem!
Kështu po e bëjnë tani, sapo u njoftua në lajmet e kanalit 4. Facebook do të tarifojë të gjithë përdoruesit që nga e hëna. Mund të zgjedhësh ta bësh këtë. Mbajeni gishtin në këtë mesazh dhe kopjojeni. Nuk mund të ndahet. Unë nuk i jap leje Facebook për të tarifuar 4.99 dollarë në muaj në llogarinë time, gjithashtu; të gjitha fotot e mia janë prona ime dhe JO Facebook!!! Falenderim i veçantë për Larry-n për këtë këshillë ligjore... dhe Tim Barker për postimin e këtij informacioni:
Sepse të gjithë po rrëmbehen ngadalë po rrëmbehen jo hakerohen po na rrëmbejnë llogaritë tani edhe më shumë
Vetëm në rast se një avokat na këshilloi ta postonim këtë. Shkelja e privatësisë mund të dënohet me ligj. SHËNIM: Facebook Meta tani është një ent publik. Të gjithë anëtarët duhet të postojnë një shënim si ky. Nëse nuk publikon një deklaratë të paktën një herë, ajo teknikisht lejon përdorimin e fotove të tua, si dhe informacionet që përmban përditësimet e statusit të profilit tënd.
UNË NUK I JEP FACEBOOK-ut LEJEN TIME PËR TË PËRDORUR ASNJË NGA TË DHËNAT E MIA PERSONALE.
Kopjoni dhe ngjisni, mos e ndani. Po marr më shumë postime shitjesh sesa postime miqsh.
Mbajeni gishtin kudo në këtë postim dhe klikoni në "kopje". Shkoni në faqen tuaj ku shkruan "Çfarë po mendoni. "Trokit gishtin kudo në fushën e zbrazët. Kliko dhe ngjite. Kjo përditëson sistemin.

2 — 1 share

Like — Comment — Share

### Përgjegjësia e verifikimit

Le të fillojmë duke theksuar qartë se qysh në vitin 2019 ky postim u zhvlerësua si i rremë nga medie të ndryshme të njohura të lajmeve dhe organizata të kontrollit të fakteve si BBC News, Snopes (një uebsajt i njohur për kontrollin e fakteve), apo edhe vetë Facebook-u. Të gjithë arritën në të njëjtin përfundim se postimi i këtij mesazhi nuk ka ndikim në parametrat e privatësisë së përdoruesve dhe nuk i ndryshon kushtet e shërbimit të platformës, të cilat çdo përdorues i pranon (pa lexuar) me krijimin e një llogarie në Facebook.

Ju gjithashtu mund të bëni një hulumtim të vogël për këtë çështje. Teksti i vitit 2023 i përmban tre emra

lajmet e Channel 4, një avokat Larry dhe Tim Barker. Ky i fundit është emri i një përdoruesi që ka postuar këtë mesazh. Larry është një avokat i panjohur, pa mbiemër, pa fushë ekspertize apo kompani ku punon, me fjalë të tjera nuk ka kredenciale fare, dhe i treti është "Channel 4", një kanal televiziv britanik i njohur i lajmeve i prodhuar nga ITN. Nëse kërkoni në arkivin e këtij kanali në lidhje me njoftimin ligjor në Facebook, rezultatet do të jenë zero.

### Të marrim përgjegjësinë tonë

Ne e ndamë këtë përvojë si një shembull tipik se si natyra e medieve sociale ndihmon në mbajtjen gjallë të dezinformimit. Shumë përdorues të Facebook-ut po mashtrohen sërish me këtë dezinformim dhe po e ndajnë gjerësisht mesazhin, duke besuar se po e ruajnë privatësinë e tyre. Duhet theksuar se në këtë rast nuk kemi asnjë dëmtim apo dhunë të drejtpërdrejtë, përveç ndoshta kundër imazhit të Facebook.




***Prandaj, mos harroni që gjithmonë të VERIFIKONI informacionin tuaj përpara se të ndihmoni në përhapjen e tij. Po ashtu, ndihmoni në zbardhjen e çdo informacioni të pasaktë ose të rremë. Kjo është mënyra më e mirë për të kontribuar në luftën kundër dezinformimit!***

Na vizitoni në:
Visit us at:

# NAVIGATING THE DIGITAL AGE

## THE IMPORTANCE OF INFORMATION VERIFICATION

***The importance of the invention of social media is simply mind-boggling. These platforms have enabled people to create global networks of cooperation, reestablish connections with childhood friends or distant family members, earn serious money, get fast information about events and news from all over the world, and the list keeps growing.***

### The 'Curse' of social media

All the benefits, however, come with a certain 'price' or, better said, 'risk.' The risk that the information we access is not confirmed, and consequently might be wrong, biased, or in the worst-case scenario straightforwardly maliciously intended to spread false news and unnecessary panic.

In comparison to our parents' time, whose source of information were various media outlets that informed the public in line with a set of rules that were in place to ensure the veracity, accuracy, and integrity of their news, it is now in our own hands to make sure that the news we read is true and accurate. Even more so if we decide to share the said news with our relatives or friends. Because if we do not do that, we facilitate the spreading of ***DISINFORMATION.***

### A lesson from a Facebook post

To give you a better understanding of this issue, we will share with you a recent experience with a Facebook post that most of you have already seen and which fortunately has not had any serious effects except the fact that it enforced beliefs of conspiracy theories and preyed on the public's concern about online privacy and safety. We are talking about the post that went quite viral in 2019 and has recently resurfaced again. Although the general idea is the same, the resurfaced post contains the following text: ***"That's what they're doing now, it was just announced on channel 4 news. Facebook will charge all users from Monday. You can choose to do this. Touch and hold this message and copy it. It cannot be shared. I don't give Facebook permission to charge $4.99 to the timeline, either; all my photos are my property and NOT Facebook!!! Special thanks to Larry for this legal tip... and Tim Barker for posting the info: Because everyone is being hijacked easily, they are being hijacked, not hacked, our accounts are being hijacked now even more. Just because a lawyer advised us to post this. Violation of privacy may be punishable by law. NOTE: Facebook Meta is now a public entity. All members should post a note like this. If you don't publish one, that technique allows photos to be visible, as well as information that isn't located in your profile status. I DO NOT GIVE FACEBOOK MY PERMISSION TO USE ANY OF MY PERSONAL DATA.***

### The responsibility of verification

Let us start by directly stating the obvious that already in 2019, this post was debunked as false by various renowned news outlets and fact-checking organizations such as BBC News, Snopes (a well-known fact-checking website), or even Facebook itself. They all came to the same conclusion that posting this message has no impact on the users' privacy settings and does not change the platform's terms of service, which every user accepts (without reading) upon creating a Facebook account.

You can also do a little research yourself on this matter. The 2023 text contains three names Channel 4 news, a lawyer Larry and Tim Barker. The latter is the name of a user that has posted this message. Larry is an unknown lawyer, no last name, field of expertise or company he works for, in other words no credentials at all, and the third is "Channel 4," a well-known British television news program produced by ITN. If you search the archive of this channel about the Facebook legal notification, you get zero results back.

### Embracing our responsibility

We shared this experience with you as a typical example of how the nature of social media helps keep disinformation alive. Many Facebook users are falling again for this disinformation and sharing the message widely, believing they are safeguarding their privacy. It should be noted, that in this case we have no direct harm or violence, except maybe against Facebook image.

***So, remember to always VERIFY your information before helping spread it. Also help in debunking any inaccurate or false information. That is the best way you can contribute to the fight against disinformation!***

# Mendimi juaj për filmat me super heronj?



## FION MUSTAFA

**Cili është mendimi juaj për filmat me super heronj?**
Unë mendoj se filmat me super heronj janë mjaft atraktiv për fëmijët sepse i bëjnë ata që të përdorin imagjinatën më shumë dhe ua zhvillon të menduarit. Këta filma kanë ndikim të madh te gjenerata të ndryshme duke i frymëzuar në tejkalimin e vështirësive në jetë, marrjen e gjërave më me sportivitet dhe duke ua ngulitur humanizmin në mendjet e tyre.

**Cili është filmi me super heronj që ju pëlqen më së shumti dhe pse?**
Filmi që më pëlqen mua më së shumti është "The Avengers". Ky film më pëlqen më së shumti sepse na mëson që ne nuk duhet të dorëzohemi kurrë, sepse e mira gjithmonë fiton në fund.

**Pse janë filmat me super heronj të rëndësishëm?**
Unë mendoj se filmat me super heronj janë të rëndësishëm sepse na tregojnë se gjithmonë në çdo vështirësi e kemi dikë në krahun tone që do të na ndihmojë të ecim para. Si dhe i nxitë njerëzit që ta ndihmojnë çdo qenie në vështirësi.

**Nëse do të mund të zgjidhnit cilën super fuqi do të dëshironit ta keni dhe pse?**
Nëse do të mund që të zgjidhja se çfarë super fuqie të kem, do të dëshiroja që të jem i shpejtë si drita, sepse do të mund t'i ndihmoja të gjithë në çdo kohë.

**What is your opinion on superhero movies?**
I think superhero movies are very attractive to children because they make them use their imagination more and develop their way of thinking. These movies have a great impact on different generations and inspire them to overcome difficult moments in their life, as well as be rather sporty with many things, by instilling humanity in their minds.

**What is your favourite superhero movie and why?**
The movie that I like the most is "The Avengers". I like this movie the most because it teaches us that we should never give up because good always wins in the end.

**Why are superhero movies important?**
I think that movies with super heroes are important because they show us that in any difficulty we always have someone on our side who will help us move forward. They also encourage us to help anyone that is going through hard time.

**If you could choose what superpower would you like to have and why?**
If I could choose what superpower to have, I would want to be as fast as the Flash because I could help everyone at any time.



## ERIS TERNAVA

**Cili është mendimi juaj për filmat me super heronj?**
Mendoj se filmat me super heronj janë të mirë për shkak se argëtohesh duke i shikuar dhe nuk përmbajnë tema që janë të dëmshme për fëmijët.

**Cili është filmi me super heronj që ju pëlqen më së shumti dhe pse?**
Filmi im i preferuar me super heronj është Spider-Man. Arsyeja pse ky film më pëlqen më shumë është atmosfera që e transmeton filmi dhe është përplot me adrenalinë.

**Pse janë filmat me super heronj të rëndësishëm?**
Mendoj se filmat me super heronj janë të rëndësishëm, sepse përmes tyre fëmijët në njëfarë mënyre sfidohen me veten. Kur them sfidohen me veten, e kam fjalën për zhvillimin e imagjinatës së tyre, sepse e dimë që këta filma nuk janë real.

**Nëse do të mund të zgjidhnit cilën super fuqi do të dëshironit ta keni dhe pse?**
Po të mund ta zgjidhja një superfuqi do të ishte të mund të bëhem i padukshëm, në mënyrë që të mos më shihte askush dhe të mund të shkoja kudo që të dëshiroja.

**What is your opinion on superhero movies?**
I think superhero movies are good because they are fun to watch and don't contain themes that are harmful to children.

**What is your favourite superhero movie and why?**
My favourite superhero movie is Spider-Man. The reason I like this movie the most is the mood this movie conveys and it is full of adrenaline.

**Why are superhero movies important?**
I think that superhero movies are important, because through them, kids challenge themselves in a way. When I say challenge themselves, I am talking about developing their imagination, because we know that these movies are not real.

**If you could choose what superpower would you like to have and why?**
If I could choose a superpower, it would be to become invisible so that no one could see me and I could go anywhere I wanted.

**Ju lutemi na dërgoni mendimet tuaja për super heronjët në këtë email:
magazineforyou2003@gmail.com**

# Your opinion on superhero movies?



## SUELA TERNAVA

**Cili është mendimi juaj për filmat me super heronj?**
Filmat me super heronj janë një mënyrë e mire për ta zhvilluar imagjinatën. Kështu duke qenë një person që më pëlqen të shikoj filma fantastiko-shkencor, filmat me super heronj janë shumë të përshtatshëm për mua.

**Cili është filmi me super heronj që ju pëlqen më së shumti dhe pse?**
Filmi me super heronj që më pëlqen më së shumti është Spider-Man. Sepse, ai në film shprehet si një karakter heroik që shpëton mijëra njerëz nga armiqtë e tij.

**Pse janë filmat me super heronj të rëndësishëm?**
Filmat me super heronj janë të rëndësishëm pasi që është një mënyrë e mirë për t'u argëtuar në kohën e lirë.

**Nëse do të mund të zgjidhnit cilën super fuqi do të dëshironit ta keni dhe pse?**
Njëra nga super fuqitë që do të dëshiroja ta kisha do të ishte fluturimi, sepse e marr me mend se parë nga lartë vendet do të kishin një pamje magjepsëse. E pse jo, edhe të beja gjiro në shumë vende që nuk i kam vizituar.

**What is your opinion on superhero movies?**
Superhero movies are a good way to develop the imagination. So, being a person who likes to watch sci-fi movies, superhero movies are very suitable for me.

**What is your favourite superhero movie and why?**
My favourite superhero movie is Spider-Man, because, in the movie, he is a hero who saves thousands of people from his enemies.

**Why are superhero movies important?**
Superhero movies are important, as it is a good way to have fun in your free time.

**If you could choose what superpower would you like to have and why?**
One of the superpowers I wish I had would be flying, because I imagine places would look amazing from above, and why not, I would even travel to many places that I have not visited.

**Please send us your thoughts on superheros at this email: magazineforyou2003@gmail.com**



## LIJANA KONJUHI

**Cili është mendimi juaj për filmat me super heronj?**
Mendoj se filmat me super heronj janë argëtues dhe emocionues! Filmat me super heronj ju pëlqejnë njerëzve sepse janë plot aksion, aventura dhe heronj të fuqishëm që luftojnë për të mirën. Ata na e japin ndjesinë se çdo gjë është e mundur dhe se mund të fitojmë kundër sfidave të mëdha. Është e mahnitshme të shohësh se si forcat e mira i mposhtin forcat e këqija.

**Cili është filmi me super heronj që ju pëlqen më së shumti dhe pse?**
Unë personalisht e pëlqej filmin "Black Panther." Ky është një film i fuqishëm dhe emocionues që e shpalos historinë e një super heroi afrikan. Me pëlqen sepse e thekson rendësinë e kulturës, unitetit dhe drejtësisë.

**Pse janë filmat me super heronj të rëndësishëm?**
Filmat me super heronj janë të rëndësishëm sepse e japin shembullin e heronjve të fuqishëm që luftojnë për të mirën dhe drejtësinë. Ata na frymëzojnë të besojmë në aftësitë tona dhe të luftojmë për vlerat tona. Një film me super heronj i mirë mund të na bëjë të ndihemi të frymëzuar dhe të motivuar për të arritur gjëra të mëdha në jetë.

**Nëse do të mund të zgjidhnit cilën super fuqi do të dëshironit ta keni dhe pse?**
Nëse do të mund të zgjidhja një superfuqi, do të dëshiroja ta kem aftësinë për të lexuar mendjen e njerëzve. Kjo do të ishte shumë interesante dhe e dobishme për t'i kuptuar më mirë emocionet dhe nevojat e të tjerëve. Mund të ndihmoja në mënyrën më të mirë ata që kanë nevojë për të krijuar lidhje më të thellë me miqtë dhe familjen.

**What is your opinion on superhero movies?**
I think superhero movies are fun and exciting! People like superhero movies because they are full of action, adventure and powerful heroes fighting for the good. They give us the feeling that anything is possible and that we can win against great challenges. It is amazing to see how the forces of good overcome the forces of evil.

**What is your favourite superhero movie and why?**
I personally love the movie "Black Panther." This powerful and exciting film unfolds the story of an African superhero. I like it because it emphasizes the importance of culture, unity and justice.

**Why are superhero movies important?**
Superhero movies are important because they set the example of powerful heroes fighting for good and justice. They inspire us to believe in our abilities and fight for our values. A good superhero movie can make us feel inspired and motivated to achieve great things in life.

**If you could choose what superpower would you like to have and why?**
If I could choose a superpower, I would want to have the ability to read people's minds. This would be very interesting and useful to better understand the emotions and needs of others. I could best help those who need to create deeper connections with friends and family.

# VITI RI, DIÇKA E RE NË TY? APO - T'VAZHDOJMË ME T'VJETRËN?

*Përpara se të rendisim vendimet më të mira të Vitit të Ri për adoleshentët, do të shqyrtojmë disa këshilla që do t'ju ndihmojnë të arrini vendimet tuaja, në vend që thjesht t'ju lodhim për një ose dy javë dhe më pas t'i ktheheni jetës si më parë. Nëse jeni serioz për t'i mbajtur vendimet tuaja të Vitit të Ri, hidhini një sy këshillave të mëposhtme dhe më pas shikojeni listën e vendimeve të mundshme për adoleshentët.*




### Zgjidhni disa

*Qëllimi këtu nuk është që ju absolutisht të merrni çdo vendim të kësaj liste. Edhe nëse e zgjidhni vetëm një, por i përmbaheni, deri në vitin tjetër do të keni përparuar shumë.*

### Si t'iu përmbaheni vendimeve tuaja të Vitit të Ri?

*Bëni gjërat që ju duket se përputhen me natyrën tuaj dhe gjithçka tjetër pështateni me karakterin tuaj dhe atë se si e shihni veten në lidhje me mbajtjen e synimeve, mbajtjen e drejtimit tuaj, pëcjelljen e gjëave, etj.*

### Merrni vendime konkrete

*Le të përdorim një nga vendimet më popullore të Vitit të Ri, vetëm për këtë shembull... Në vend që të "humbni peshë", merrni vendim ... "do të bëj të paktën 3 shëtitje të gjata çdo javë dhe do të sigurohem që ta ha numrin e duhur të kalorive çdo ditë."*

### Mos e bëj atë!

*Edhe nëse është gusht, tetor ose madje edhe - dhjetor... ju mund të synoni të merrni sa më shumë vendime që të jetë e mundur, dhe është prapë më mirë se asgjë. Është në rregull t'i përditësoni vendimet e Vitit të Ri në mes të vitit për t'i bërë ato pak më të lehta, ose pak më sfiduese, ose çfarëdo që ju nevojitet.*

### Zgjidhni vendime të arritshme

*Një mënyrë e mirë për t'iu qasur vendimeve është t'i shikoni ato si përmirësime të vogla dhe të qëndrueshme që mund t'i bëni. Nuk duhet ta sforconi veten shumë apo edhe të merrni vendime super sfiduese, sepse ato do t'ju bëjnë që të dorëzoheni shumë shpejt. I duruari, i fituari.*

***Më poshtë është lista jonë e vendimeve të Vitit të Ri për adoleshentët, shpresojmë se do të gjeni disa ide të mira këtu.***

**Detoksifikim dixhital - Të shkëputem nga rrjetet sociale për të paktën 24 orë çdo muaj këtë vit**

Detoksifikimi dixhital i Vitit të Ri për adoleshentët 24 orë, kjo është 1 ditë në muaj ku abstenoni plotësisht nga përdorimi i mediave tuaja sociale. Pavarësisht nëse janë TikTok, IG, Snap, BeReal, apo çfarëdo llogarish të tjera të medieve sociale që ju bëjnë të lundroni në telefonin tuaj, a mendoni se mund të jetoni pa to për 24 orë në muaj? Zgjidhni një ditë çdo muaj, kaq, dhe bëjeni këtë tërë vitin, dhe do ta keni përmbushur këtë vendim.



# NEW YEAR, NEW YOU? OR WILL IT BE - THE SAME OLD AGAIN?

*Before we list the best New Year's resolutions for teens, we're going to go over some tips that will help you actually achieve your resolutions, instead of just getting you hyped up for a week or two and then going back to life as usual. If you're serious about keeping your New Year's resolutions, take a look at some of the tips below, and then continue on to see the list of resolutions for teens.*

### Pick and choose a few

*The goal here is absolutely not for you to do every single resolution on this list. Even if you pick one and stick to it, you'll be that much further ahead by the next year.*

### How to keep your New Year's resolutions?

*Do the stuff that sounds like it'll work for you and adapt the rest to fit your personality and how you know yourself and what works for you when it comes to keeping your goals, staying on track, keeping track of things, and so on.*

### Make them actionable

*Let's use one of the most popular New Year's resolutions, just for this example... Instead of "lose weight", make your resolution... "I will go for at least 3 long walks each week, and ensure that I'm eating the correct number of calories each day."*

### Don't do that!

*Even if it's August, October, or heck - December... you can still aim to do as much of your resolution as possible, and it's still better than nothing. It's OKAY to update your New Year's resolutions mid-way through the year to make them a bit easier, or a bit more challenging, or whatever you need.*

### Choose realistic resolutions

*A good way to look at resolutions is to think of them as small and consistent improvements you can make. It's not about going all-out and picking super challenging ones, cos that will make you so much more likely to fizzle out early. Slow and steady wins the race.*

**Here's our New Year's resolution list for teenagers, hopefully, you'll find some good ideas here.**

**Digital detox - Unplug from social media for at least 24 hours each month this year**
New Year's digital detox for teens 24 hours, that's 1 day per month where you completely abstain from checking your social media. Whether it's TikTok, IG, Snap, BeReal, or whatever other social media accounts keep you scrolling on your phone, do you think you can live without them for 24 hours per month? Pick one day each month, that's it, and do this for the entire year, and you'll have accomplished this resolution.

**Read more - Read at least 12 books this year**
Reading more is a popular New Year's resolution for teens. In months when you won't be reading as much, you could choose shorter books. If you feel like reading a lot, pick a longer book. And it doesn't have to be done on a month-to-month basis, either.

**Learn new words - Work to expand vocabulary by learning new words**
Be careful, the goal here isn't to learn a bunch of obscure words so that nobody can understand you and you seem pretentious. The goal here is to learn new words that you can fit perfectly in when they're the best word to say what you need to say. It's about utility, not just showing off flowery language.

**Reduce junk food intake - Cut certain junk food out of my life**
There are some healthier foods that you can eat instead or even healthier versions of the foods you enjoy, so that's worth taking into consideration, too. You don't have to completely eliminate all of your favourite foods if you love eating these types of things, but moderation is important.

**Increase family time - Make more time to get close to family**
It doesn't have to be some grand vacation or huge event, it could just be picking a show you both enjoy and watching it together once a week with your younger sibling, or king dinner together with your dear grandma, or whatever your family situation might look like.

**Të lexoj më shumë - Të lexoj të paktën 12 libra këtë vit**
Të lexosh më shumë është një zgjedhje popullore e Vitit të Ri për adoleshentët. Në muajt kur nuk jeni në disponim të lexoni aq shumë, mund të zgjidhni libra me më pak faqe. Nëse keni dëshirë të lexoni shumë, zgjidhni një libër më të gjatë. Dhe nuk është e thënë që patjetër të jetë një libër në muaj.

**Të mësoj fjalë të reja - Të punoj për të zgjeruar fjalorin duke mësuar fjalë të reja**
Kujdes, qëllimi këtu nuk është të mësoni një mori fjalësh të paqarta në mënyrë që askush të mos ju kuptojë dhe të dukeni mendjemadh. Qëllimi këtu është të mësoni fjalë të reja me të cilat mund të përshtateni në mënyrë të përkryer kur ato janë fjala më e mirë për të thënë atë që duhet të thoni. Bëhet fjalë të jeni i dobishëm, e jo vetëm të dukeni kinse e keni mësuar një gjuhë të re.

**Të zvogëloj konsumimin e ushqimeve të shpejta - Të largoj nga jeta ime disa ushqime të padëshiruara**
Ka disa ushqime të shëndetshme apo edhe versione më të shëdetshme të ushqimeve që ju pëqejnë, që ia vlen t'i merrni në konsideratë. Nuk është e thënë t'i eliminoni plotësisht të gjitha ushqimet tuaja të preferuara nëse ju pëlqen t'i hani ato gjëra, por është me rëndësi të tregoni kujdes ndaj sasisë.

**Të kaloj më shumë kohë me familjen - Të gjej më shumë kohë për t'u afruar me familjen**
Nuk duhet të jetë ndonjë pushim madhështor ose një ngjarje e madhe, mund të jetë thjesht zgjedhja e një shfaqjeje që të dy palëve ju pëlqen dhe ta shikoni së bashku një herë në javë me vëllanë ose motrën tuaj më të vogël, ose të hani një darkë të begatshme bashkë me gjyshen tuaj të dashur, ose çkado qoftë që ju afron me familjen tuaj.

Let's learn TOGETHER!

# Festat e fundvitit Novogodišnji i božićni praznici







## Fjalor - Rečnik

| | |
|---|---|
| Festat e fundvitit | Novo-godišnji praznici |
| Krishtlind-jet | Božić |
| Viti i Ri | Nova godina |
| Dritat | Svetla |
| Gëzim | Radost |
| Mrekulli | Čudo |
| Gosti | Gozba |
| Vendimet e Vitit të Ri | Novogo-dišnje odluke |
| Urim | Čestitka |
| Dëshirë | Želja |
| Shkëlqim | Sjaj |
| Argëtim | Zabava |
| Zbukurime | Ukrasi |
| Këngë | Pesma |
| Muzikë | Muzika |
| Vallëzim | Ples |





















Jelka



Slatkiši



Dreni

# Festat e fundvitit
# Novogodišnji i božićni praznici



Jelena

4You magazine

## Fjalor - Rečnik

| | |
|---|---|
| Bredhi i Vitit të Ri | Božićna jelka |
| Shaka | Šala |
| Shije | Ukus |
| Ëmbëlsira | Slatkiši |
| Ushqime tradicionale | Tradicionalna hrana |
| Mikpritje | Gostoprimstvo |
| Nata e Vitit të Ri | Doček Nove Godine |
| Veshje festive | Praznična odeća |
| Festa e Vitit të Ri | Novogodišnja žurka |


















Kapa



Poklon



Deda mraz




“Asnjëherë nuk është vonë për t'u bërë ai që dëshironi të jeni. Shpresoj që të jetoni një jetë për të cilën jeni krenarë dhe nëse e kuptoni se nuk jeni, shpresoj të gjeni forcën për të filluar nga e para.”

***F. Scott Fitzgerald***